



UNIVERSITETI I PRISHTINË
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT

PLANI ZHVILLIMOR I FAKULTETIT TË EDUKIMIT 2022-2026

PPRISHTINË, 2022



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I EDUKIMIT**

Rr. Agim Ramadani, Fakulteti i Edukimit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +383 38 229 201 • E-mail: edukimi@uni-pr.edu • edukimi.uni-pr.edu

**PLANI ZHVILLIMOR I FAKULTETIT TË EDUKIMIT
2022-2026**

Prishtinë, 2022

Procesi i hartimit të këtij dokumenti është realizuar në kuadër të projektit QATEK-Towards a Quality Oriented teacher Education in Kosovo, mbështetur nga Programi Erasmus Plus.

PËRMBAJTJA

GRUPI PUNUES	4
1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE	6
2. HYRJE	8
2.1 Historiku i shkurtër i zhvillimit të fakultetit	9
2.2 Fakulteti i Edukimit sot	12
2.3 Konteksti më i gjerë i sistemit të arsimit	15
2.4 Sistemi i licencimit të mësimdhënësve dhe standardet e profesionit	17
3. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE	18
3.1. Programet e përgatitjes së mësimdhënësve	18
3.2. Sistemi i sigurimit të cilësisë	19
3.3. Aktiviteti shkencor	20
3.4 Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim të Arsimit dhe lidhja me mjedisin	21
3.5. Resurset njerëzore	23
3.6. Menaxhimi, administrata dhe infrastruktura	24
3.6.1. Struktura e departamenteve	24
3.6.2. Infrastruktura dhe qasja në burimet e mësimin	25
4. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT	26
4.1. Vizioni i Fakultetit të Edukimit	26
4.2. Misioni i Fakultetit të Edukimit	26
4.3. Vlerat	27
Përsosshmëria dhe inovacioni	27
Etika dhe integriteti akademik	27
Fokusi tek studenti	27
Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi	27
Fuqizimi	28
5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	29
5.1. Përshkrimi i objektivës së përgjithshme strategjike	30
5.2. Përshkrimi i objektivës specifike 1: Mësimdhënia dhe të nxënit	32
5.2.1. Rezultatet, aktivitetet dhe treguesit për objektivën specifike 1	33
5.3. Përshkrimi i objektivës specifike 2: Hulumtimi, inovacioni dhe ndërkombëtarizimi	36
5.3.1. Rezultatet, aktivitetet dhe treguesit për objektivën specifike 2	37
5.4. Përshkrimi i objektivës specifike 3: Rrjetëzimi komunitar dhe partneriteti	39
5.4.1. Rezultatet, aktivitetet dhe treguesit për objektivën specifike 3	41

5.5. Përshkrimi i objektivës specifike 4: Qeverisja, administrimi dhe menaxhimi	43
5.5.1. Rezultatet, aktivitetet dhe treguesit për objektivën specifike 4	44
6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	47
6.1. Përcaktimi i kornizës për monitorim	47
6.2. Metodologjia dhe instrumentet	47
6.3. Përcaktimi i grupit monitorues	47

Lista e tabelave

Tabela 1. Numri i studentëve të regjistruar në vitin akademik 2020/2021	13
Tabela 2. Numri i studentëve të diplomuar gjatë pesë viteve të fundit	13
Tabela 3. Numri i studentëve të regjistruar në studimet Master në vitin akademik 2020/2021	13
Tabela 4. Numri i studentëve të diplomuar në studimet Master gjatë 5 viteve të fundit	14
Tabela 5. Numri i studentëve të regjistruar në studimet e Doktoraturës	14
Tabela 6. Të dhënat për aplikantë dhe të regjistruar në programet Baçelor dhe master.....	15

GRUPI PUNUES

Grupi i punës që ka kontribuar në hartimin e këtij plani:

Blerim Saqipi, Dekan

Majlinda Gjelaj, Prodekane për doktoraturë, zhvillim dhe cilësi

Blerita Perolli-Shehu, Prodekane për çështje mësimore – studimet master

Kastriot Buza, Prodekan për çështje mësimore – studimet Baçelor

Shefat e departamenteve: Rozafa Shala, Hatixhe Ismajli, Naser Zabeli, Sylejman Berisha, Kyvete Shatri.

Këshilli i studimeve të doktoratës: Eda Vula, Hatixhe Ismajli, Naser Zabeli, Zeqir Veselaj, Arlinda Beka.

Sekretaret e departamenteve: Adelina Hajrullahu, Veli Kryeziu, Donika Koliqi, Florent Bunjaku, Blerina Tafolli.

Komisioni i studimeve: Vlora Sylaj, Fatlume Berisha, Atdhe Hykolli, Teuta Danuza, Albulena Metaj.

Këshilli i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim të Arsimit: Kyvete Shatri, Arlinda Damoni, Rozafa Shala.

Milaim Mazreku, Sekretar

Fjolla Kacaniku, Sekretare e IHZhA

Jeta Aliu, Zyrtare e ZZHA-s

Administrata: Vera Sopi, Aferdita Buqani, Irfan Miftari.

Përfaqësuesi i studentëve: Albin Hoxha.

Lista e shkurtesave

AAK	Agjencia e Akreditimit e Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
CIDA	Agjencia Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar
ECTS	Sistemi Evropian për Transferimin e Krediteve
FEdu	Fakulteti i Edukimit
GiZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
IHZhA	Instituti për Hulumtime dhe Zhvillim të Arsimit
KEDP	Projekti për Aftësimin e Mësimdhënësve Kosovarë
KKK	Korniza e Kurikulës e Kosovës
MASHTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
PISA	Programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve
PEST	Politike, ekonomike, sociale dhe teknologjike
QATEK	Përgatitja cilësore e mësimdhënësve në Kosovë
SHML	Shkolla e mesme e lartë
SHMU	Shkolla e mesme e ulët
SWOT	Sukseset, dobësitë, mundësitë, rreziqet
TI	Teknologjia e Informacionit
TEMPUS	Programi Trans European për Studime Universitare
TLP	Programi për Lidërsipin e Transformuar
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
UP	Universiteti i Prishtinës
ZZhA	Zyra për Zhvillim Akademik

1. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Fakulteti i Edukimit pas 20 vitesh të funksionimit të tij si njësi akademike në Universitetin e Prishtinës, ka kaluar nëpër sfida të ndryshme që janë ndërlidhur me ndryshimet shoqërore dhe reformat e vazhdueshme të sistemit të arsimit përfshirë dy reforma kurrikulare të njëpasnjëshme si dhe ndryshime të vazhdueshme në standardet dhe strukturimin e programeve për përgatitjen e mësimitdhënësve të rinj. Në përgjithësi këto përpjekje janë drejtuar drejt avancimit të konceptit të profesionalizmit në profesionin e mësuesisë krahas nevojës për balancim mes përgatitjes akademike, pedagogjike dhe praktike të mësimitdhënësve të rinj.

Në shënimin e 20 vjetorit të themelimit të Fakultetit të Edukimit, në vazhden e investimeve të njëpasnjëshme disaveçare fakulteti ka arritur të stabilizohet nga intervenimet emergjente që kërkonin zhvillimet në sistemin shkollor dhe të kalojë në një fazë kur planifikimi strategjik ka për qëllim ruajtjen dhe rritjen e vazhdueshme të cilësisë së përgatitjes së mësimitdhënësve të rinj. Plan i zhvillimitor 2022-2026, i shërben zhvillimit të qëndrueshëm institucional dhe të përgatitjes cilësore të mësimitdhënësve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe nevojës së shoqërisë për një mësimitdhënës i cili është në gjendje të ndjek hapat e zhvillimit dhe transformimit socio-ekonomik, politik, shkencor e teknologjik të shoqërisë sonë në veçanti dhe transformimit global.

Ky plan zhvillimor kaloi në një proces gjithëpërfshirës konsultativ duke bashkuar në një grup përfaqësues nga të gjitha strukturat e fakultetit përfshirë stafin akademik, administrativ dhe studentët. Plan i zhvillimitor pas dakordimit të grupit punues, diskutoi me të gjithë stafin dhe me akterët relevant të sistemit të arsimit duke përfshirë MASHTI, IPK, OJQ dhe drejtues të shkollave dhe kopshteve. Në fund për t'u miratuar zyrtarisht në Këshillin e Fakultetit. Në kuadër të këtij plani, mbi bazën e realitetit aktual dhe sipas kërkesave të kohës janë përcaktuar vizioni dhe misioni i Fakultetit të Edukimit si dhe vlerat mbi bazën e së cilave ndërtohet filozofia e punës përgjatë viteve në vijim.

Prandaj, vizioni i Fakultetit të Edukimit është:

Fakulteti i Edukimit, institucion udhëheqës në Kosovë për përgatitjen e mësimitdhënësve dhe profesionistëve arsimor, kompetentë në zbatimin e praktikave inovative të mësimitdhënies, të nxënit dhe kërkimit që synojnë zhvillimin e potencialit maksimal të secilit individ në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit dhe në përputhje me trendet e zhvillimit global.

Misioni i Fakultetit të Edukimit i përcaktuar në këtë Plan Zhvillimor është: *ofrimi i programeve cilësore për përgatitjen dhe aftësimin e vazhdueshëm të edukatorëve, mësimitdhënësve dhe specialistëve të tjerë në fushën e edukimit, zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore dhe rrjetëzimi në komunitet, në funksion të avancimit të sistemit të orientuar në nevojat e shoqërisë, në edukim cilësor dhe në zhvillim të njohurive, shkathtësive dhe vlerave në shoqëri.*

Bazuar në analizën SWOT dhe PEST grupi punues identifikoi objektiven kryesore strategjike dhe katër objektiva specifike në të cilat integrohet natyrshëm komponenta e sigurimit të cilësisë. Objektiva strategjike kryesore e Fakultetit të Edukimit për periudhën pesë vjeçare synon zhvillimim e një kulture organizative të zbatimit të programeve bazuar në standardet e cilësisë dhe profesionit. Kjo reflektohet

në mësimdhënien e bazuar në kërkim shkencor, në funksion të zhvillimit të mësimdhënies cilësore si mjet për ndryshimin e realitetit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet edukative. Objektivat specifike që mbështesin realizimin e saj janë:

Objektiva specifike 1: MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Zhvillimi i praktikave inovative të mësimdhënies, të nxënit dhe vlerësimit, fuqizimi i bashkëpunimit kolegjal dhe ndërdisiplinor, ndërlidhja e teorisë me praktikën dhe hulumtimin shkencor përmes zbatimit të mekanizmave të qëndrueshëm dhe të matshëm të sigurimit të cilësisë, ashtu që studentët të marrin përvoja cilësore që i kontribuojnë zhvillimit dhe rritjes së tyre personale dhe profesionale, e cila reflektohet në punën e tyre në institucionet edukative.

Objektiva specifike 2: HULUMTIMI, INOVACIONI DHE NDËRKOMBËTARIZIMI

Avancimi në hulumtime shkencore përmes promovimit të hulumtimeve të integruara, përfshirjes së studentëve në hulumtime shkencore dhe mobilitete ndërkombëtare, rritjes së bashkëpunimit në projekte kombëtare duke krijuar partneritet me shkolla dhe institucione parashkollore dhe në projekte ndërkombëtare, dhe zhvillimit të programeve të integruara konform nevojave të tregut të punës.

Objektiva specifike 3: RRJETËZIMI KOMUNITAR DHE PARTNERITETI

Ndikim dhe kontribut i shtuar në komunitet përmes pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese me institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët, rritje e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë sociale përmes kontributit të drejtpërdrejtë në shërbime në komunitet si dhe rritje e përmbajtjeve programore që synojnë zhvillimin e ndërmarrësisë tek studentët.

Objektiva specifike 4: QEVERISJA, ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI

Zhvillimi i kulturës së qëndrueshme organizative institucionale përmes zbatimit të politikave dhe standardeve të qëndrueshme të cilësisë, llogaridhënies dhe transparencës; investimit në zhvillimin profesional të stafit akademik dhe administrativ dhe përfshirjes së studentëve në vendimmarrje dhe në proceset e sigurimit të cilësisë.

Nga ky Plan Zhvillimor derivojnë planet e veprimit njëvjeçar që zbërthejnë rezultatet e pritura dhe aktivitetet e përgjithshme në aktivitete konkrete e tregues të matshëm, si dhe përcakton bartësit e këtyre aktiviteteve dhe kornizën kohore për kryerjen e tyre. Ky plan veprimi shoqërohet me një vlerësim të shpenzimeve për zbatimin e tij, i cili është hartuar duke pasur parasysh autonominë financiare të kufizuar të Fakultetit.

2. HYRJE

Fakulteti i Edukimit shënon 20 vjetorin e themelimit në tetor të vitit 2022. Kjo shërben si pikë e rëndësishme e reflektimit të rrugës së ndjekur dhe e definimit të frymës, përmbajtjes dhe qasjes së zhvillimit në rrugën përpara. Edhe sistemi i përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë ka kaluar nëpër sfidën e zhvillimit të fushës së edukimit si shkencë dhe vendosjen e saj si disiplinë shkencore qoftë brenda universitetit apo në kontekstin më të gjerë të zhvillimit të shkencës. Ky transformim, natyrisht se ishte më i vonshëm në Kosovë, por nuk është shumë i hershëm as në vendet e tjera të Evropës perëndimore. Këto dy elemente duhet të analizohen; në njërën anë nga perspektiva e synimeve të sistemit të përgatitjes së mësimdhënësve për përafrim me praktikën e mira ndërkombëtare, dhe në anën tjetër duke trajtuar specifikat e kontekstit vendor, përfshirë edhe dimensionin historik të zhvillimit të përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë.

Edhe përkundër debatit të vazhdueshëm rreth cilësisë së mësimdhënësve në dy dekadat e fundit, sistemi i arsimit në Kosovë nuk ka arritur të prodhojë të dhëna empirike rreth cilësisë së mësimdhënësve të rinj si një prej fushave specifike që duhet trajtuar më me urgjencë. Të dhënat dhe referencat që kanë ekzistuar janë të formës së dokumenteve strategjike apo janë të dhëna observuese që lidhen me cilësinë e dobët të rezultateve të nxënësve në kontekstin shkollor. Në periudhën pas pjesëmarrjes së Kosovës në vlerësimet ndërkombëtare (duke filluar me vlerësimin PISA 2015), perceptimi rreth cilësisë së mësimdhënies në shkollë - rrjedhimisht edhe rreth cilësisë së përgatitjes së mësimdhënësve - filloi të formësohet më qëndrueshëm rreth nevojës për ndryshim në sistemin e përgatitjes së mësimdhënësve.

Fakulteti i Edukimit është një nga fakultetet e vetme në Universitetin e Prishtinës që ka pasur një plan zhvillimi, zbatimin e të cilit u përmbyll në vitin 2018. Në periudhën tetor 2020 dhe gjatë vitit 2021, menaxhimi i fakultetit u bazua në programin e dekanit, program ky, i cili shërbeu edhe si pikë nismëtare për zhvillimin e planit aktual zhvillimor. Shumë prej aspekteve përmbajtësore që u vlerësuan nga ekspertët e vlerësimit të jashtëm në vitin 2021, si pjesë e akreditimit të programeve, si ide që duhet promovuar tutje u transferuan në këtë plan. Hartimi i këtij plani zhvillimor është bazuar edhe në shumë zhvillime të tjera në sistemin e arsimit parauniversitar si dhe në zhvillimet në kontekstin shkollor në Kosovë. Po ashtu, procesi i hartimit të tij ka ndjekur një qasje të brendshme pjesëmarrëse dhe konsultative për të arritur në një formë që e vendosë këtë plan si dokument udhëzues për të gjithë akterët brenda fakultetit.

Ky plan zhvillimor është hartuar për periudhën 5 vjeçare, përmes një procesi konsultativ, duke shfrytëzuar grupin e punës si mekanizëm të debatit dhe përcaktimit të kaheve, objektivave dhe përmbajtjes së aktiviteteve. Gjatë procesit, përveç takimeve të grupeve të vogla të punës, janë bërë edhe punëtori e aktivitete të ndryshme të grupit të zgjeruar të punës, si dhe konsultime me forume më të gjëra si Këshilli i Fakultetit, kolektivi i fakultetit si dhe partnerët zhvillimor dhe palët e tjera të interesit.

Gjatë procesit të hartimit të këtij plani janë shfrytëzuar këto burime të të dhënave:

- Konkludimet e dala nga punëtoritë konsultuese të grupit hartues dhe takimet e punës;

- Raportet e ekspertëve nga akreditimi i programeve të studimit në fakultet në vitin 2021;
- Raportet vjetore dhe përvojat paraprake në zbatimin e projekteve të bashkëpunimit ndërkombëtar (TEMPUS, TLP, Programet e financuara nga Ambasada Amerikane, etj);
- Analiza e situatës së programeve realizuar në kuadër të projektit QATEK;
- Të dhënat e nxjerra nga pilotimi i instrumenteve për sigurimin e cilësisë brenda fakultetit;
- Programi i dekanit 2020-2024 dhe përvoja e implementimit në vitin e parë;
- Plani i punës i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim të Arsimit (IHZhA);
- Politikat dhe planifikimi strategjik në nivel të sistemit të arsimit në Kosovë (PSAK);
- Dokumentet strategjike dhe orientimet e zhvillimit në rregullativën qendrore të universitetit.

Gjatë procesit të planifikimit janë zbatuar edhe analizat SWOT si dhe PEST me grupin hartues për të përcaktuar realitetin dhe prioritetet, si dhe janë definuar edhe deklaratat e misionit dhe vizionit për fakultetin. Ambicioziteti i planit zhvillimor është bazuar në realitetin e supozuar që universiteti, shteti dhe shoqëria do të jenë të mobilizuar drejtë përkrahjes së implementimit të tij, ku secila palë bënë pjesën e vet të punës. Në këtë kontekst, përgatitja e mësimdhënësve cilësor duhet të shihet nga një këndvështrim më i gjerë i funksionimit të sistemit arsimor. Një frymë e tillë është reflektuar edhe në dokument.

2.1 Historiku i shkurtër i zhvillimit të fakultetit

Përgatitja e mësimdhënësve në Kosovë ka një histori relativisht të gjatë duke filluar me përgatitjen e mësimdhënësve në Shkollën Normale në vitin 1953. Si vazhdimësi e kësaj, u themeluan Shkollat e Larta Pedagogjike (SHLP) si institucione post-sekondare për përgatitjen e mësimdhënësve në Kosovë. Përgatitja e mësimdhënësve në Kosovë, në nivel të shkollave të larta, ka filluar që në vitin 1958 kur është hapur Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Më vonë, këtij institucioni i janë shtuar edhe shkollat e larta pedagogjike në Prizren, në Gjakovë dhe në Gjiçan, të cilat prej vitit 1980 janë bërë pjesë e Universitetit të Prishtinës. Shkollat e larta pedagogjike kanë ofruar programe dyvjeçare studimi të orientuara në përgatitjen e studentëve për ciklin klasor (klasat 1-4) dhe ciklin lëndor (klasat 5-8) të nivelit të arsimit fillor, ku programet lëndore kanë qenë të përqendruara në një ose dy disiplina. Në vitin 1997/98 ka filluar punën Fakulteti i Mësuesisë, i cili ka ofruar program 3 dhe 4 vjeçar për mësuesit e ciklit lëndor.

Ndërkaq, në vitin 2001, pas transformimeve të rëndësishme në arsimin e Kosovës dhe hapave të parë në reformimin e mësimdhënies në shkolla, kanë filluar përgatitjet për themelimin e Fakultetit të Edukimit. Fakulteti ka filluar punën në vitin shkollor 2002/03 si rezultat i bashkëpunimit të MASHT, Universitetit të Prishtinës dhe Projektit për Aftësimin e Mësimdhënësve Kosovarë (KEDP), të financuar nga Agjencia Kanadeze për Zhvillim Ndërkombëtar (CIDA). Fillimisht, u zhvilluan vetëm programet për përgatitjen e edukatorëve dhe mësuesve të ciklit fillor (klasat 1-5). Ndërkaq, nga viti akademik 2003/2004 u zhvilluan dhe filluan të zbatohen edhe programet për përgatitjen e mësimdhënësve për ciklin e mesëm të ulët – mësimdhënës lëndorë të klasave 6–9: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Gjuhë dhe Letërsi Angleze, Matematikë - Informatikë, Teknologji - Informatikë, Fizikë - Kimi, Biologji - Kimi, Histori - Edukatë Qytetare, dhe Gjeografi - Edukatë Qytetare. Këto programe mundësuan përgatitjen e mësimdhënësve dylëndorë në përputhje me standardet e aftësimin të mësimdhënësve dhe u ofruan në formë të studimeve themelore baçelor, me kohëzgjatje 4 vjeçare me 240 kredite ECTS. Në vitin shkollor

2010/11, në kuadër të projektit të financuar nga programi "Tempus" i Komisionit Evropian, fakulteti regjistroi studentët e parë në dy programet e para master: "Mësimdhënia dhe Kurrikula" dhe "Udhëheqja Arsimore". Deri në vitin 2010, Fakulteti i Edukimit funksionoi në katër qendra: në Prishtinë, në Prizren, në Gjilan dhe në Gjakovë.

Në shtator të vitit 2010, Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AAK) akreditoi katër programe të Fakultetit të Edukimit për periudhën trevjeçare: Programin parashkollor dhe Programin fillor (në të tri qendrat), si dhe dy programet e sapofilluara master. Ndërkaq, të gjitha programet e tjera që ofronin përgatitjen e mësimdhënësve për ciklin e mesëm të ulët – mësimdhënës lëndorë, u akredituan për një periudhë njëvjeçare, dhe atë vetëm në qendrën e Prishtinës.

Në nëntor 2011, ministri i arsimit, shkencës dhe teknologjisë formoi një grup pune me detyrë që të adresojë rekomandimet nga raporti i vlerësimit të ekspertëve të Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AAK) dhe të propozojë strukturën e re të programeve për përgatitjen e mësimdhënësve. Në bazë të rekomandimeve të grupit të punës, më 16 korrik 2012 ministri mori vendim që të gjithë ofertuesit publikë të arsimit të lartë të rishikojnë programet e tyre për përgatitje të mësimdhënësve në përputhje me kërkesat e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës të miratuar në vitin 2011 dhe në linjë me rekomandimet e AAK. Vendimi ofronte disa orientime të përgjithshme për riorganizimin e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve, duke përcaktuar ndarjen e përgjegjësive për aftësimin akademik dhe pedagogjik të mësimdhënësve të ardhshëm të profilit lëndor.

Në bazë të Vendimit të Ministrit të arsimit nr. 191/01B të dt. 16.07.2012 që përcakton kushtet e reja për funksionimin e programeve për përgatitjen e mësimdhënësve, Universiteti i Prishtinës hartoi planin për ristrukturimin e programeve studimore për përgatitjen e mësimdhënësve. Nga viti 2014/2015 filloi ofrimi i programeve të reja të studimit për përgatitjen e mësimdhënësve lëndorë. Më 8 prill 2013 MASHT lëshoi Udhëzuesin nr. 049/01B për zbatimin e Vendimit të Ministrit dhe Universiteti i Prishtinës filloi zbatimin e plotë të sistemit të ri të programeve për përgatitjen e mësimdhënësve. Në kuadër të këtyre ndryshimeve ishte edhe vendimi i Agjencionit të Akreditimit për bartjen e Departamentit të Pedagogjisë nga Fakulteti Filozofik në kuadër të Fakultetit të Edukimit. Por, një reformë e tillë nuk u monitorua nga afër nga institucionet përgjegjësve e sidomos në raport me standardet dhe struktura e programeve tjera të mësuesisë në universitetet e tjera publike që u hapën në ndërkohë.

Gjatë vitit akademik 2015/2016 u akreditua edhe programi i studimeve të doktoratës në bashkëpunim me Universitetin e Lublanës dhe Universitetin e Tiranës, si universitete partnere. Po ashtu, me vendimin e datës 05.09.2016 Ref. 782/16 të Agjencionit të Kosovës për Akreditim u akredituan edhe programet Master i Mësimdhënies lëndore, MA, 120 ECTS (me specializimet: Matematikë; Fizikë; Biologji; Kimi; Histori; Gjeografi, Teknologji dhe TIK), Master i Pedagogjisë për Shkollat Profesionale, MA, 120 ECTS; dhe Master i Edukimit Inkluziv, MA, 60 ECTS. Në ndërkohë filloj edhe përgatitja për mbylljen e programeve lëndore 60 ECTS. Të gjitha programet e mësipërme u përgatitën në kuadër të Projektit Tempus "Modernizimin i Edukimit të Mësimdhënies në Universitetin e Prishtinës" me ndihmën e partnerëve ndërkombëtar- Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Jyväskylä (JAMK) Finlandë, Universiteti i Bedfordshire në Britani të Madhe, Universiteti i Bolonjës në Itali dhe Universiteti i Lublanës në Slloveni.

Përpjekjet për reformë jo gjithmonë dhe jo mjaftueshëm janë mbështetur me resurse të vazhdueshme. Për këtë arsye, shpesh herë zhvillimet dhe ndërhyrjet në sistemin e përgatitjes së mësimdhënësve janë përqendruar në nivelin strukturor. Trendi i këtyre ndërhyrjeve ka qenë tendenca që të rritet standardi i kualifikimit të mësimdhënësve nga niveli dy vjeçar i shkollave të larta pedagogjike (SHLP), që ka ekzistuar në të kaluarën, në nivel të kualifikimit 4 vjeçar me themelimin e Fakultetit të Edukimit në vitin 2002. Në fillim të kësaj reforme ka pasur një entuziazëm ndaj qasjes që me implementim të reformës strukturore do të adresohet edhe ajo përmbajtësore.

Në dekadën e parë pas përfundimit të luftës, sfida e Fakultetit të Edukimit ka qenë prodhimi i mjaftueshëm i kuadrove për të plotësuar nevojat e shkollave për të gjitha profilet e duhura. Në shumë fusha pati mangësi, ndërsa paralelisht trajtohej edhe sfida e përgatitjes cilësore të mësimdhënësve me shumë aktivitete për të ofruar edhe programe të ndryshme të zhvillimit profesional. Në dekadën pasuese, dy ishin orientimet zhvillimore kryesore. Në njërën anë filloi hapja e universiteteve tjera publike, pra pavarësimi dhe rritja e degëve të deriatëhershme të Fakultetit të Edukimit, ndërsa në anën tjetër filluan edhe nismat për ofrimin e programeve që siguronin avancimin e kualifikimit të mësimdhënësve ekzistues me kualifikim më të ulët se niveli Bachelor. Qendrat në Prizren, Gjiilan dhe në Gjakovë, vazhduan punën në kuadër të universiteteve të reja publike të themeluara në këto qytete.

Krahas kësaj, Fakulteti i Edukimit u përball edhe me rritjen e kuotave për pranim të studentëve - sidomos në periudhën 2011 - 2016 - dhe kjo për disa vite më pas shkaktoi edhe rritjen e proporcionit staf - studentë dhe me vete solli edhe shumë sfida të tjera të zbatimit cilësor të programeve si në dimensionin teorik ashtu edhe në dimensionin praktik në shkollë. Të gjitha këto zhvillime nuk u përcollën me rritjen e duhur të personelit akademik e administrativ dhe me rritjen e resurseve në dispozicion për të përkrahur implementimin e duhur të programeve. Për të kuptuar sfidat e sigurimit të resurseve të mjaftueshme njerëzore, si ilustrim, në vitin 2012/2013, fakulteti ka pasur 77 mësimdhënës dhe asistentë në kuadër të personelit akademik, ndërsa tani ka vetëm 56, në mesin e tyre 42 profesorë dhe 14 asistentë. Në vitin 2012/2013, proporcioni staf-studentë ka qenë 1 me 23 e që konsiderohej i lartë, ndërsa ky proporcion tani është 1 me 55 studentë. Ky raport shumë i lartë është larg çfarëdo norme jo vetëm të vendeve të zhvilluara, por edhe nëse krahasohet me fakultetet dhe universitetet e tjera në Kosovë. Duhet cekur se këtë raport e rritë edhe numri i madh i studentëve jo-aktiv, të cilët sistemi i lejon të mos humbasin statusin e studentit përkundër mospërfshirjes së tyre në ligjërata dhe provime për vite me radhë.

Megjithatë, përkundër sfidave, dekada e fundit pati edhe zhvillime pozitive për Fakultetin e Edukimit, kryesisht në fushën e bashkëpunimi ndërkombëtar, investimit në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të stafit akademik dhe administrativ, dhe investimit në infrastrukturë. Fakulteti i Edukimit, përmes projekteve që ka menaxhuar, ka organizuar në vazhdimësi aktivitete të zhvillimit profesional të stafit akademik në metodologji të mësimdhënies, planifikim të mësimin, vlerësim e hulumtime në arsim, trajnime këto të dizajnuara dhe fasilituara nga profesorët e Universiteteve partnere nga Evropa dhe SHBA. Përpos reformave përmbajtësore në programet e studimit, janë bërë edhe investime në profesionalizimin e mëtejshëm të stafit akademik përmes programeve TEMPUS dhe TLP, me ç'rast është konstituuar një bashkëpunim shumë i ngushtë me Universitete eminentë evropiane dhe amerikane, si Universiteti i Lubjanës, Universiteti Bedfordshire në Angli, Universiteti Jyväskylä në Finlandë,

Universiteti i Bolonjës në Itali, Universiteti Indiana dhe Iowa në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Profesorë nga këto Universitete kanë dizajnuar programet përkatëse të trajnimit dhe mbështetjes akademike për stafin akademik në Fakultetin e Edukimit, programe këto që janë zbatuar në vazhdimësi në dekadën e fundit dhe kanë dhënë rezultate në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Këto zhvillime në dekadën e fundit, kanë rëndësi të madhe për t'u marrë si referencë për përcaktimin e qasjes së zhvillimit në të ardhmen si dhe duke pasur parasysh këtë përvojë, ky Plan Zhvillimor do të përcaktojë jo vetëm përmbajtjen, por edhe qasjen e implementimit të veprimeve që çojnë drejt përmirësimit të cilësisë së implementimit të programeve dhe cilësisë së të diplomuarve.

Duke ditur rrugën që ka ndjekur Kosova në reformën strukturore të programeve që përgatisin mësimdhënës në dy dekadat e fundit, natyrisht që fokusi tani do të vendoset më shumë në reformën e përmbajtjes dhe cilësinë e implementimit të programeve për përgatitje të mësimdhënësve sesa në ridefinim të standardit për kualifikim. Sado që qëndron kritika që testet e standardizuara ndërkombëtare si PISA nuk mund të merren si shabllone për të vlerësuar cilësinë e mësimit në shkolla - sidomos në rrethanat e tranzicionit nga kurrikula e vjetër që po bënë Kosova - megjithatë këto vlerësime shënuan një pikë kthese në dakordimin e akterëve dhe shoqërisë për nevojën e ngritjes së profesionalizmit në kontekst të përgatitjes së mësimdhënësve dhe mësimdhënies në shkollë. Andaj, synimi i këtij plani do të jetë që të fasilitojë rrugëtimin e Fakultetit të Edukimit drejt një kulture zhvillimore të orientuar në cilësi e që merr parasysh historikun e zhvillimit, gjendjen e tanishme në fakultet si dhe vizionin e përcaktuar për profesionin e mësuesisë dhe fakultetin.

2.2. Fakulteti i Edukimit sot

Fakulteti i Edukimit, njëra nga 14 njësitë akademike në kuadër të Universitetit të Prishtinës, njihet si një nga fakultetet më të mëdha për nga numri i studentëve si dhe institucioni më i madh i përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë. Fakulteti ka aktualisht 56 mësimdhënës (profesorë dhe asistentë) dhe 3500 studentë të regjistruar si aktiv.

Fakulteti i Edukimit në vitin akademik 2021/2022 ka të akredituar tri programe të nivelit Baçelor duke përfshirë:

- Edukimi në fëmijërinë e hershme (240 ECTS)
- Edukimi fillor (240 ECTS), dhe
- Pedagogji e përgjithshme (180 ECTS).

Në nivelin Master janë të akredituara 2 programe me specializime të veçanta:

- Master në Shkenca të Edukimit (me specializim në: Këshillim pedagogjik, Mësimdhënie dhe Kurrikula, Udhëheqje në arsim dhe Edukim inkluziv) 120 ECTS.
- Master i Mësimdhënies lëndore (me specializim në: Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, Mësimdhënia e matematikës, Mësimdhënia e Fizikës, Mësimdhënia e Kimisë,

Mësimdhënia e Biologjisë, Mësimdhënia e Historisë, Mësimdhënia e Gjeografisë, Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIKU-t) 120 ECTS.

Statistikat flasin për një trend në rënie të numrit të kandidatëve për studime në programet e nivelit Baçelor dhe kjo jo si rrjedhojë e rënies së interesimit për studime në këtë fakultet, por për shkak të ngritjes së kriterëve të pranimit me qëllim të rritjes së cilësisë së zbatimit të programeve.

TABELA 1. NUMRI I STUDENTËVE TË REGJISTRUAR NË VITIN AKADEMIK 2020/2021

Programi	Viti I	Viti II	Viti III	Viti IV	Gjithsej
Parashkollor / Edukimi në fëmijërinë e hershme	60	54	118	226	458
Fillor/Edukimi fillor	75	119	112	445	751
Pedagogji	45	42	112	/	199
Edukimi në fëmijërinë e hershme (0-3 vjeç)				16	16
Gjithsej					1424 studentë

Në vitin akademik 2021/2022 në Fakultetin e Edukimit kanë regjistruar semestrin si studentë aktivë në studimet Baçelor, gjithsej 1424 studentë, prej të cilëve 733 e kanë përsëritur vitin (shih Tabela 1.)

TABELA 2. NUMRI I STUDENTËVE TË DIPLOMUAR GJATË PESË VITEVE TË FUNDIT

Programi	2020/2021	2019/2020	2018/2019	2017-2018	Gjithsej
Parashkollor	71	79	60	140	350
Fillor	224	275	221	318	1038
Pedagogji	66	117	78	95	356
Edukimi në fëmijërinë e hershme (0-3 vjeç)	25	80	31	29	165
Gjithsej					1909 studentë

Numri i studentëve të diplomuar në programet Baçelor i paraqitur në Tabelën 2., tregon rënie të numrit të të diplomuarve duke ndjekur trendin e regjistrimit të studentëve në pesë vitet e fundit. Duhet përkujtuar se vite më parë numri i studentëve të pranuar në Fakultetin e Edukimit ka qenë dhjetëfish më i lartë se këto pesë vitet e fundit dhe kjo ka ndikuar që të ketë disproporcion të madh midis numrit të të diplomuarve dhe atyre të regjistruar.

Sa i përket të dhënave statistikore për studimet e nivelit Master, vërehet se numri i studentëve në grupe është optimal duke synuar ruajtjen e cilësisë në ofrimin e studimeve dhe raportin studentë/mësimdhënës. Studimet Master ofrojnë mundësi të shumta të studimeve si në programet e përgjithshme të edukimit, ashtu edhe në ato të përgatitjes së mësimdhënësve lëndorë dhe tejkalojnë numrin e programeve të nivelit Baçelor. Numri i të diplomuarve në nivelin master është në rritje duke pasur parasysh kohën e hapjes së programeve (shih Tabelën 3 dhe 4.)

TABELA 3. NUMRI I STUDENTËVE TË REGJISTRUAR NË STUDIMET MASTER NË VITIN AKADEMIK 2020/2021

Programi	Viti I	Viti II	Gjithsej
Master në Shkenca të Edukimit: Udhëheqja në Arsim	30	30	60
Master në Shkenca të Edukimit: Mësimdhënia dhe Kurrikula	30	30	60
Master në Shkenca të Edukimit: Edukim Inkluziv	30	40	70

Master në Shkenca të Edukimit: Këshillim Pedagogjik	30	40	70
Master i Pedagogjisë për Shkollat Profesionale	/	23	23
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe	30	30	60
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Matematikës	30	33	63
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Teknologjisë dhe TIK-ut	27	34	61
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Kimisë	30	31	61
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Biologjisë	30	40	70
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Fizikës	20	13	33
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Historisë	30	31	61
Master i Mësimdhënies Lëndore: Mësimdhënia e Gjeografisë	20	25	45
Gjithsej	337	400	737

TABELA 4. NUMRI I STUDENTËVE TË DIPLOMUAR NË STUDIMET MASTER GJATË 5 VITEVE TË FUNDIT

Programi	2020/2021	2019/2020	2018/2019	2017/2018	Gjithsej
Master i Edukimit : Udhëheqje në Arsim	34	28	33	29	124
Master i Edukimit : Mësimdhënie dhe kurrikulë	33	34	37	23	127
Master në Edukimin Inkluziv	21	9	13		43
Master i Pedagogjisë për Shkolla Profesionale	12	4	7		23
Pedagogji -Drejtimi Teorik shkencor	17	16	8	24	65
Master në mësimdhënie e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe	14	23	25	21	83
Master i Mësimdhënies lëndore me specializim në Matematikë	22	16	6		44
Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Teknologji dhe TIK	22	10	4		36
Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Kimi	21	5	13		39
Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Biologji	22	22	20		64
Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Fizikë	12	6	2		20
Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Histori	11	10	1		22
Master i mësimdhënies lëndore me specializim në Gjeografi	16	6	3		25
Gjithsej					715

Sa i përket numrit të studentëve të regjistruar në nivelin e doktoraturës, në tri gjenerata që nga viti 2016 deri në vitin 2018, janë pranuar dhe vazhdojnë studimet gjithsej 21 studentë. Pesë kandidatë kanë dorëzuar punimin final për vlerësim dhe u janë caktuar komisionet vlerësuese; pritet që brenda vitit 2022 të diplomohen dhe të marrin titullin e Doktorit të Shkencave në Edukim (shih. Tabelën 5).

TABELA 5. NUMRI I STUDENTËVE TË REGJISTRUAR NË STUDIMET E DOKTORATURËS

Programi	2016/2017	2017/2018	2018/2019
Doktoraturë në Edukim	12	6	3
Gjithsej			21 studentë

Rënia e interesimit të studentëve për studim në arsimin e lartë është reflektuar edhe në Fakultetin e Edukimit në vitet e fundit. Megjithatë, fakulteti vazhdon të jetë ende ndër fakultetet më të kërkuara në Universitetin e Prishtinës edhe në nivel të shtetit. Në disa programe, si ai i Edukimit Fillor, vazhdon të ketë konkurrencën 5 aplikantë për një vend të lirë në nivelin baçelor, ndërsa në nivelin master konkurrencë e lartë ekziston tek specializimet e programit Master në Shkencat e Edukimit si Edukimi Inkluziv, Udhëheqja në Arsim, Mësimdhënia dhe Kurrikula, dhe Këshillimi Pedagogjik. Tabela 6 më poshtë jep detajet e aplikantëve dhe të pranuarve në dy vitet e fundit për të demonstruar interesimin e lartë, por megjithatë në rënie të të rinjve për të hyrë në profesionin e mësuesisë.

TABELA 6. TË DHËNAT PËR APLIKANTË DHE TË REGJISTRUAR NË PROGRAMET BAÇELOR DHE MASTER

Viti akademik	Programi fillor		Programi parashkollor		Master në mësimdhënien lëndore/8 drejtime		Master në shkencat e edukimit/ 4 drejtime	
	Aplikantë	Të pranuar	Aplikantë	Të pranuar	Aplikantë	Të pranuar	Aplikantë	Të pranuar
2021-2022	368	70	152	60	479	220	927	120
2020-2021	564	120	227	60	504	250	1067	140

2.3 Konteksti më i gjerë i sistemit të arsimit

Asnjëherë nuk mund të trajtohet në mënyrë të duhur praktika e mësimdhënies dhe zhvillimi i mësimdhënësve në një kontekst pa pasur parasysh edhe specifikat dhe variablat e rëndësishme të sistemit të arsimit në të cilin janë përgatitur dhe në të cilin funksionojnë mësimdhënësit. Edhe pse literatura akademike potencon faktin që mësimi i nxënësve në masë të madhe varet nga qasja dhe veprimet e mësimdhënësve në klasë, për të kuptuar mirë peshën e ndikimit dhe sfidat kryesore të mësimin duhet kuptuar edhe detajet e funksionimit të profesionit të mësuesisë dhe shkollat. Zhvillimi i profesionit të mësuesisë në Kosovë është ngushtë i lidhur me zhvillimet në sistemin shkollor, sidomos në tri dimensione:

- Reforma kurrikulare;
- Standardet e profesionit të mësuesisë;
- Raporti në mes të kërkesës dhe ofertës në përgatitjen e mësimdhënësve.

Të gjitha këto referime kanë qenë në zhvillim të vazhdueshëm varësisht nga përpjekjet e ministrive të arsimit për të vendosur një standard dhe për të inkurajuar iniciativat zhvillimore në nivel të profesionalizimit të punës së mësimdhënësve. Kosova ka kaluar nëpër dy reforma kurrikulare në dy dekadat e fundit dhe ka pasur një numër dokumentesh referuese për standardet e profesionit të mësuesisë.

Në anën tjetër, edhe pse në nivel më të përgjithshëm, Planet Strategjike të Arsimit në nivel vendi kanë shërbyer dhe shërbejnë edhe më tej si pika referimi për zhvillimin e profesionit të mësuesisë. Pas

skadimit të Planit Strategjik 2017-2021, MASHTI zhvilloi Planin e ri strategjik, i cili në formën aktuale ka promovuar, ndër të tjera, disa politika inovative që profesioni i mësuesisë duhet t'i përvetësojë. Ndër to është edhe nevoja për zhvillimin e kompetencës digjitale në profesionin e mësuesisë bazuar në realitetin e ri post-COVID, por jo vetëm; si dhe, aspektet e trajtimit të inkluzionit dhe diversitetit si vazhdimësi e përpjekjeve të mëhershme. Në anën tjetër, ky Plan Strategjik i MASHTI ka avokuar edhe nevojën për përgatitjen e mësimitdhënësve në raport me politikat kurrikulare dhe zhvillimet në sistemin shkollor në Kosovë. Kjo, me fjalë të tjera, paraqet edhe nevojën për përgatitjen e mësimitdhënësve të orientuar në praktikë.

Aktualisht, politika kryesore e definimit të profesionalizmit të mësimitdhënësve është Korniza Strategjike e Zhvillimit të Mësimitdhënësve në Kosovë, e miratuar nga MASHT në vitin 2017. Ky dokument, ndër të tjera, e bën edhe definimin e kompetencave të mësimitdhënësve në fazat e ndryshme të karrierës duke përfshirë edhe fazën e kualifikimit fillestar, pra përfundimin e programit të përgatitjes si mësimitdhënës. Ky standard/dokument parasheh një gamë të gjerë të kompetencave që janë tipike për profilin e mësimitdhënësit cilësor. Standardet dhe idetë e avokuara nga dokumentet strategjike në Kosovë (Kurrikula e re & Profili i kompetencave të mësimitdhënësve në Kornizën Strategjike të Zhvillimit të Mësimitdhënësve në Kosovë) janë në përkrahje të qasjes që përgatitja e mësimitdhënësve të rinj duhet të synojë jo vetëm përgatitjen e mësimitdhënësve si implementues të kurrikulës së re, por si mësimitdhënës që krijojnë kurrikulën dhe udhëheqin ndryshimin në shkollë.

Një nga zhvillimet më madhore në sistemin e arsimit parauniversitar në Kosovë është reforma kurrikulare, e cila u formalizua si nismë në vitin 2011, por e cila gjatë procesit kaloi edhe nëpër rishikime e modifikime të tjera. Arsyeshmëria e kësaj reforme ka qenë mbi të gjitha edhe nevoja e kalimit nga një kurrikulë e orientuar në objektiva drejt qasjes së bazuar në kompetenca. Pra, esenca e reformës kurrikulare ka qenë dhe mbetet ndryshimi i praktikave të mësimitdhënies në klasë duke synuar fokusin në zhvillimin e shkathtësive dhe vlerave të formësuara si kompetenca.

Kurrikula e re e Kosovës është e orientuar në zhvillimin e gjashtë kompetencave që tek gjeneratat e reja do të reflektohen në kuptim të krijimit të profilit të nxënësve që janë:

- Komunikues efektiv
- Mendimtar kreativ
- Nxënës i suksesshëm
- Kontribuues produktiv
- Individ i shëndoshë
- Qytetar i përgjegjshëm

Në esencë reforma kurrikulare përveç pritjeve nga gjeneratat e reja ka pasur për qëllim edhe ndryshimin e sjelljes profesionale të mësimitdhënësve në detyrë si dhe ndryshimin e kulturës organizative në shkollë. Një nga parimet e zhvillimit të kurrikulës së re ka qenë edhe autonomia e shtuar e shkollës dhe e mësimitdhënësit në zbatimin e orientimeve kryesore nga dokumenti bërthamë në planifikimin në shkollë dhe në zhvillimin e kurrikulës me zgjedhje. Këto me idenë e rritjes së përgjegjësisë në nivel shkollor për të përcaktuar edhe angazhimin dhe përshtatjen ndaj specifikave të shkollave dhe komunitetit që i shërbejnë. Kjo kulturë kërkon edhe nivel të shtuar të profesionalizmit të

komunitetit në shkollë duke kaluar nga zbatimi i gatshëm i udhëzuesve dhe kurrikulave të detajuara, në një proces ku shkolla angazhohet në përvetësimin e dokumenteve kurrikulare për të planifikuar kurrikulat vjetore e tutje në nivel të planeve mësimore. Ky proces u tregua si shumë ambicioz në fazat e para, dhe në vitet pas pilotimit sistemi i arsimit shkoi edhe më tej drejt përshkrimit të dokumenteve shtesë kurrikulare në mënyrë që shkollat ta kenë më lehtë zbatimin e këtij ndryshimi. Në anën tjetër, kjo e minimizoi ambicien e rritjes së përgjegjësisë në nivel shkolle për aktivitete planifikuese dhe zhvillimore.

2.4. Sistemi i licencimit të mësimit dhe standardet e profesionit

Një nga pikat e referimit në zhvillimin e politikave dhe praktikave të përgatitjes së mësimit të rinj është sistemi i licencimit të mësimit në Kosovë. Ky sistem për më shumë se 10 vite është përdorur si mekanizëm për motivimin e mësimit për performancë të mirë në një anë, dhe ngritjen e standardit të kualifikimit të mësimit të rinj në anën tjetër.

Në kuadër të sistemit të licencimit u ndërtua karriera e mësimit me idenë e vendosjes së një vazhdimësie nga kualifikimi fillestar (para shërbimit) drejt fazës hyrëse në profesion (e cila ende vazhdon të jetë e munguar) dhe drejtë zhvillimit profesional në karrierë. Në kuadër të këtij sistemi (pjesa që është relevante për punën e fakultetit) u zhvillua profili i kompetencave të mësimit brenda Kornizës Strategjike të Zhvillimit të Mësimit (2017), ku u saktësuan kompetencat që duhen reflektuar të diplomuarit nga programet që përgatisin mësimit. Përderisa në kontekstin vendor merret si pikë referimi profili i kompetencave të mësimit në Kornizën Strategjike të Mësimit (2017), në nivel Evropian, korniza e kompetencave për mësimit e vitit 2013 vazhdon të jetë pikë referimi për zhvillimin e mësimit në vende të ndryshme (https://ec.europa.eu/assets/eac/education/experts-groups/2011-2013/teacher/teachercomp_en.pdf)

Në kuadër të sistemit të licencimit të mësimit janë paraparë edhe aktivitetet e zhvillimit profesional të mësimit që adresojnë zhvillimin e kompetencave të nevojshme për mësimit cilësor, e që në raste të caktuara, veprojnë edhe si shtytës të implementimit të reformave arsimore. Këto nisma e aktivitete duhet të shërbejnë edhe si aspekte për të lidhur zhvillimet në sektorin e zhvillimit të mësimit në karrierë me përpjekjet për të përgatitur mësimit të rinj që janë të gatshëm për ballafaqim me sfidat dhe realitetin e punës së mësimit. Ndërsa, sfidat dhe realiteti i mësimit të rinj janë të përcaktuar drejtpërdrejtë nga konteksti i punës së tyre.

Në vitet e fundit, trendet demografike, rritja e numrit të universiteteve publike, trendet e migrimit jashtë vendit, si dhe rënia e përgjithshme e interesimit të të rinjve për të studiuar në arsimin e lartë, shkaktuan rënie në numrin e aplikantëve në programet që përgatisin mësimit. Kjo lidhet edhe me debatin në sistem të arsimit që numri i mësimit të nevojshëm në sistem është duke u zvogëluar si dhe me mbiprodhimin e kuadrove në një periudhë të caktuar në dekadën e fundit. Ky element i kontekstit duhet të jetë pikë kthese në planifikimin e programeve, kuotave dhe qasjes zhvillimore duke i dhënë prioritet cilësinë ndaj sasisë dhe duke vendosur në ballë të agjendës zhvillimore mësimit e së ardhmes si udhëheqës të zhvillimeve në sistemin e arsimit parauniversitar. Për të funksionuar ndryshe nevojiten edhe kuadro të përgatitura ndryshe dhe kjo duhet drejtojë zhvillimet në vitet në vijim; natyrisht, pa

injuar sfidat e palëve të përfshira në proces dhe pa minimizuar rreziqet që dalin nga synimet e ndryshimit të gjendjes ekzistuese përmes projekteve të vogla dhe afatshkurta.

3. ANALIZA E GJENDJES EKZISTUESE

Analiza e gjendjes ekzistuese është bërë përmes qasjes konsultative në punëtori me grupin hartues të këtij plani zhvillimor. Po ashtu, janë marrë të dhëna që janë në dispozicion nga raportet vjetore të fakultetit, raportet e ndryshme statistikore dhe analitike, si dhe nga raportet e ekspertëve të jashtëm të agjencionit të akreditimit. Gjatë punëtorive me grupin hartues, analiza u përqendrua kryesisht në formën e analizës SWOT dhe analizës PEST. Konkludimet e nxjerra nga këto të dhëna janë përshkruar më poshtë.

3.1. Programet e përgatitjes së mësimdhënësve

Fakulteti i Edukimit ka një traditë relativisht të gjatë të zhvillimit, implementimit dhe reformimit të programeve. Ka kaluar nëpër një numër reformash në nivel sistemi, më saktësisht krahas avancimit të standardit të kualifikimit të mësimdhënësve, të cilat automatikisht shpjen në nevojën për ndryshim të programeve. Krahas kësaj, edhe reforma kurrikulare, e cila është bërë në mënyrë të vazhdueshme në dy dekadat e fundit (duke përfshirë dy reforma të mëdha të iniciuara në 2001 dhe 2011), në mënyrë të drejtpërdrejtë nënkuptuan nevojën e ndryshimeve programore në fakultet. Fakulteti i Edukimit në bashkëpunim me projektet ndërkombëtare, dhe konform reformave në nivel sistemi, ka bërë ndërhyrje programore (gjithnjë me pjesëmarrje të stafit akademik dhe partnerëve zhvillimor), ndryshime këto që në njërin anë i kanë sjellë një hap përpara programet e përgatitjes së mësimdhënësve në përmirësimin e cilësisë dhe ndërlidhjen me nevojat aktuale, por në anën tjetër kanë gjeneruar edhe shumë sfida në implementim për shkak të ndryshimeve të shpeshta nga gjenerata në gjeneratë. Po ashtu, duke qenë lidhja me të diplomuarit dhe realitetin shkollor nuk ka qenë shumë e fuqishme, megjithëse ka pasur përafrime, sërish janë hasur mospërputhje me nevojat dhe realitetin në shkolla.

Implementimi i reformës së programeve të studimit ka hasur në vështirësi shpesh edhe në vendosjen e koherencës mes kurseve që natyrshëm kanë pasur ndërlidhje përmbajtësore, dhe mes kurseve dhe programit si tërësi. Janë identifikuar raste të kurseve të përafërta që nuk kanë qenë të harmonizuara mes vete, duplikime të koncepteve mes kurseve të ndryshme, dhe sfida të tjera të ngjashme, të cilat hasen edhe sot, dhe kërkojnë vëmendje për t'u trajtuar. Po ashtu, janë hasur edhe vështirësi në zbatimin e inovacioneve në trajtimin e koncepteve ndërkurrikulare si shkathtësitë e buta, koncepti i vlerave si dhe është vërejtur përpjekje sporadike në integrimin e lëndëve të shkencave natyrore apo edhe integrimi më i gjerë STEAM. Koncepti i inovacionit në mësimdhënie në mënyrë të tërthortë është thjeshtësuar në konceptet gjenerike si përshtatja e programeve me kurrikulën shkollore, ndërsa konceptet më përmbajtësore brenda reformës kurrikulare si mësimi i bazuar në kërkim (ang: inquiry based learning), mësimdhënia me studentin në qendër, individualizimi dhe diferencimi i mësimdhënies, qasja moderne e mësimdhënies përmes zbatimit të teknologjisë, etj., kanë mbetur më shumë nën hijen e çështjeve më të përgjithshme.

Duke parë gjërat nga perspektiva zhvillimore e dy dekadave rrugëtim në përgatitjen e mësimeve të rinj, në vitin 2020, fakulteti filloi implementimin e projektit QATEK për zhvillimin e mekanizmave të sigurimit të cilësisë në programet që përgatisin mësimeve (financuar nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian). Qëllimi i projektit është ndërtimi i mekanizmave të brendshëm për të rritur cilësinë e implementimit të programeve përmes identifikimit të mangësive dhe zhvillimit të veprimeve të duhura. Si pjesë e këtij projekti, fillimisht u realizua një analizë e situatës për programet që ofrohen në fakultet krahas kornizës së BE-së për zhvillimin e kompetencave të mësimeve si dhe për praktikën e sigurimit të cilësisë në fakultet deri në atë kohë. Analiza për programet e përgatitjes së mësimeve gjeti se programet janë tejet të fokusuar në zhvillimin e njohurive, përderisa shkathtësitë zhvillohen kryesisht gjatë punës praktike. Në anën tjetër, zhvillimi i vlerave dhe krijimi i qëndrimeve duket të jetë shumë pak prezent. Analiza gjeti fokus të ultë në bashkëpunim vendor mes institucioneve të përgatitjes së mësimeve, vështirësi në integrim multidisiplinarë dhe ndërfaqësorë (p.sh. shkencat e natyrës apo integrimi STEAM), sfida në profilizim të stafit akademik në edukim, fokus të ultë në zhvillim të shkathtësive hulumtuese, analitike dhe të zgjidhjes së problemeve tek studentët, në përdorimin e teknologjive dhe metodologjive moderne, në zhvillim të aftësive të transferueshme, etj. Rekomandimet kryesore të dala nga analiza për programet e Fakultetit të Edukimit, përfshijnë:

- rritjen e lidhjes së programeve të edukimit me standardet për përgatitjen e mësimeve në Kosovë;
- forcimin e integritetit të fushave të ndryshme lëndore dhe inicimin e diskutimeve në nivel kombëtar për të ecur drejt të mësuarit të bazuar në kërkime dhe projekte;
- fuqizimin e formimit pedagogjik të studentëve dhe rritjen e bashkëpunimit të stafit akademik me shkollat, p.sh. gjetja e mundësive për të bashkëpunuar me shkollat, realizimi i projekteve zhvillimore me shkollat, puna së bashku me mësuesit për të krijuar praktika të reja mësimore;
- zhvillimi i udhëzimeve për praktikën, për përgjegjësitë e të gjitha palëve dhe kriteret e vlerësimit të studentëve.

Kjo situatë na shpie në identifikimin e nevojës që në të ardhmen të zbatohet një qasje ndryshe e planifikimit dhe reformimit të programeve duke u nisur nga korniza e pritjeve, drejt definimit të koncepteve, teorive, filozofive dhe praktikave të synuara drejt reflektimit dhe caktimit të tyre nëpër kurse individuale apo grup kurseesh. Për të realizuar këtë, nevojitet të vendoset një kulturë e planifikimit dhe shqyrtimit të përbashkët kolegjal në institucion.

3.2. Sistemi i sigurimit të cilësisë

Në pjesën e dytë të vitit 2020, fakulteti (po ashtu përmes projektit Erasmus+ QATEK) analizoi mekanizmat dhe praktikën aktuale të sigurimit të cilësisë në UP dhe gjeti një fokus në hartimin dhe miratimin e instrumenteve dhe rregulloreve (edhe pse u konstatua që në masë të madhe kishte mungesë të instrumenteve formale për shqyrtimin e cilësisë në një numër fushash), por jo edhe aq në zbatimin e tyre. Rekomandimet kryesore të dala nga kjo analizë përfshijnë mbledhjen e feedbackut të studentëve për monitorimin e mësimit dhe të nxënësve, por edhe për të mbështetur të nxënësve të studentëve; krijimin dhe zbatimin e një sistemi të shqyrtimit të performancës së stafit akademik; krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit me alumni dhe punëdhënësit, etj. Sipas analizës, zhvillimi i mëtejshëm i

mekanismave të sigurimit të cilësisë nuk duhet të fokusohet në raportimin e rezultateve të vlerësimeve, por në krijimin e formateve bashkëpunuese për përmirësimin e implementimit të programeve.

Bazuar në këto analiza, u hartua politika për sigurimin e cilësisë në Fakultet të Edukimit, e cila u miratua nga Këshilli i Fakultetit më 29 janar 2021. Qëllimi i përgjithshëm i këtij dokumenti (politikës) është të sigurojë një kornizë dhe udhëzime zbatimi për Fakultetin e Edukimit, duke prezantuar një sistem të brendshëm për sigurim të cilësisë për përgatitjen e mësimit para-shërbimit. Ky dokument synon të sigurojë një kornizë të referencës për institucionet për përgatitjen e mësimit para-shërbimit në përpjekjet për të siguruar se praktikatat për përgatitjen e mësimit para-shërbimit çojnë në zhvillimin e profesionalizmit të kërkuar të mësimit para-shërbimit në kontekstin shkollor, vendor dhe ndërkombëtar.

Si pjesë përbërëse e Politikës për Sigurimin e Cilësisë në Fakultetin e Edukimit u hartua edhe pakoja me instrumentet për shqyrtimin dhe sigurimin e cilësisë. Disa nga këto instrumente u pilotuan gjatë vitit 2021, si: vlerësimi i programeve, kurseve, pyetësori për alumni, analiza e syllabuseve, etj. dhe të gjeturat shërbyen për të identifikuar nevojat që reflektohen në këtë plan zhvillimor.

Po ashtu, si pjesë e kësaj pakoje është bërë edhe analiza e përmbajtjes së syllabuseve që është përqendruar në (i) rezultatet e pritura, (ii) metodat e vlerësimit, dhe (iii) literaturën e përdorur dhe kjo analizë ka gjetur se ekziston një numër mjaft shqetësues i syllabuseve që rezultatet e pritura i parashohin në nivel të njohurive; në kuadër të qasjes sistematike të vlerësimit mbizotëron testimi si instrument; mungon ekspozimi i studentëve ndaj shkrimit akademik, më saktësisht ndaj analizës dhe krijimit të shkruar për temat e caktuara; syllabuset rrallë herë japin shpjegim të detyrave; dhe në shumë raste literatura është e vjetërsuar apo e mangët.

Realiteti i fillimit të zbatimit konstatoi që sfidues do të jetë kapaciteti implementues i kësaj pakoje në kontekst të resurseve aktuale të Fakultetit të Edukimit për të mbledhur të dhënat, për t'i analizuar ato dhe për t'i përdorur gjetjet për vendimmarrje të bazuar. Po ashtu, mbetet sfidues edhe vetëdijësimi institucional për instalimin e kulturës së matjes dhe sigurimit të cilësisë. Por, pilotimi i instrumenteve të caktuara në vitin 2021 konstatoi që praktikatat e tilla të analizës së proceseve duhet të avancohen dhe mbështeten me resurse për të arritur në synimin final të gjenerimit të veprimeve dhe korrigjimeve të nevojshme në funksionimin e institucionit dhe implementimin e programeve. Në vitin 2021 u pilotua instrumenti për vlerësimin e kurseve (për të cilat secili nga personeli akademik ka pranuar raport individual), instrumenti për të diplomuarit lidhur me përshtypjet e tyre për gatishmërinë për profesion dhe cilësinë e programit që kanë ndjekur në fakultet, si dhe instrumenti për organizimin e mësimit praktik (praktikës pedagogjike) në shkollë.

3.3. Aktiviteti shkencor

Fakulteti i Edukimit në vazhdimësi ka zhvilluar debatin lidhur me vëllimin dhe cilësinë e punimeve shkencore të personelit akademik. Në dhjetor 2020, Agjencia e Akreditimit të Kosovës ka miratuar një standard të ri për kualifikimin dhe profilin shkencor të bartësve për akreditim të programeve të studimit. Ky standard ka përcaktuar kërkesën që bartësit e programeve të studimit duhet të kenë një

punim shkencor në revistat e indeksuara në SCOPUS apo Web of Science për programet baçelor, ndërsa dy të tilla për programet master. Për më shumë, standardi specifikon edhe nevojën që punimet e personelit akademik duhet të jenë të fushës së programit të caktuar.

Fakulteti i Edukimit ka bërë një analizë të CV-ve të stafit akademik në fund të vitit 2021, duke u fokusuar në numrin dhe natyrën e publikimeve në raport me standardin e ri të akreditimit. Tri lloje publikimesh janë gjetur në CV-të e stafit të Fakultetit të Edukimit:

- publikime në fushën e edukimit/didaktikës së fushës së ngushtë;
- publikime nga fusha e përgjithshme e edukimit, dhe
- publikime nga fusha e pastër akademike.

Për vitin 2021, janë identifikuar 17 punime të publikuara në Web of Science dhe Scopus nga ana e stafit akademik. Analiza ka gjetur se krahas nevojës për të përkrahur stafin akademik në rritjen e numrit të publikimeve, vërehet edhe nevoja për profilizim më të mirë të punës shkencore të stafit në raport me programin dhe lëndët për të cilat janë zgjedhur. Lidhja e profilit shkencor të personelit me programet e studimit dhe natyrën e studimeve dhe shkencën e edukimit është nevojë e evidente, që kërkon reagime të strukturuar. Ky realitet i ri ngrit nevojën që në Fakultetin e Edukimit të bëhet një ndryshim në qasjen e personelit akademik ndaj aktivitetit të tyre shkencor (publikimeve) duke siguruar që puna shkencore lidhet ngushtë me programet e studimit ku ata mbajnë mësim dhe është në funksion të zhvillimit të shkencës së edukimit. Në kuadër të kësaj përpjekjeje për veprime institucionale që ndryshojnë gjendjen aktuale, Këshilli i Fakultetit ka nxjerrë një Rekomandim formal në vitin 2021 për personelin për të orientuar punën shkencore në raport me kërkesat e reja të Agjencisë së Akreditimit dhe nevojës për zhvillim të shkencës së edukimit.

Në vitin 2021, përmes një qasje konsultative janë definuar 9 grupe të hulumtimit rreth 9 temave të trajtimit të koncepteve dhe fenomeneve arsimore e që do të duhej të bashkonin profesorët dhe asistentët e fushave të ndryshme në studime dhe hulumtime të përbashkëta. Kjo pritet të jetë fillimi i një dokumenti orientues për fushat prioritare dhe i një programi institucional të studimit të edukimit nga ana e fakultetit si institucion që ka pasur dhe ka këtë aktivitet në misionin e vet.

3.4 Instituti për Hulumtim dhe Zhvillim të Arsimit dhe lidhja me mjedisin

Fakulteti i Edukimit është duke bërë përpjekje për funksionalizim të Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim të Arsimit (IHZhA), i cili ishte themeluar në vitin 2014. Përveç emërimit të Bordit të Institutit, që koordinon punët e institutit në bashkëpunim dekanatin, u emërua edhe sekretari i Institutit, përgjegjës për administrimin dhe organizimin e aktiviteteve të Institutit. Gjatë vitit 2021, IHZhA organizoi 10 webinare për mësimdhënës, drejtor shkollash dhe palë të tjera të interesit, me një pjesëmarrje prej rreth 1000 akterësh. Temat e këtyre webinarëve variuan nga edukimi në fëmijërinë e hershme deri tek aspektet didaktike të mësimdhënies së lëndëve të caktuara dhe aspektet e zhvillimit të cilësisë së shkollës si organizatë.

Për më tej, në vitin 2021 IHZhA ka akredituar në MASHTI 10 programe të zhvillimit profesional të mësimdhënësve dhe udhëheqësve të shkollave. Këto programe janë listuar:

1. Ngritja e kapaciteteve në Udhëheqjen Arsimore
2. Zbatimi i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës
3. Vlerësimi përmbledhës i nxënësve: Hartimi i testit
4. Metodologjia Montessori për edukimin në fëmijërinë e hershme- mosha 0-6
5. Integrimi i TIK-ut në mësimdhënie
6. Mësimdhënia dhe të nxënësve të shkencave natyrore në klasat 1-5
7. Integrimi i edukimit për qëndrueshmëri në klasa
8. Vlerësimi i leximit në klasat e hershme – A-EGRA
9. Mentorimi i studentëve gjatë praktikës pedagogjike
10. Mentorimi kolegjal në arsim

Tashmë ka filluar implementimi i programit për vlerësimin në arsim për studentët e vitit të fundit të studimeve në programin fillor dhe grupe të caktuara të mësimdhënësve nëpër shkollat e Kosovës.

Në kuadër të bashkëpunimit me Organizatën TOKA është përgatitur edhe moduli i të nxënësve përmes përvojës. Po ashtu, në kuadër të Projektit për zhvillimin e programit të integruar të fëmijërisë së hershme, mbështetur nga UNICEF, janë zhvilluar edhe 6 module të zhvillimit profesional të edukatorëve në shërbim për fëmijërinë e hershme (zhvillimi i fëmijëve, të nxënësve përmes lojës, edukimi për vlera dhe barazia gjinore, komunikimi dhe ndërveprimi me fëmijë, familje dhe komunitete, puna me projekte edukative, dhe integrimi i teknologjisë në fëmijërinë e hershme).

Fakulteti dhe IHZha u angazhuan edhe në përpjekjet për të avancuar bashkëpunimin me shkollat në raport me nevojën e riprofilizimit dhe avancimit të aktivitetit shkencor. Në janar të vitit 2022, Fakulteti hyri në marrëveshje bashkëpunimi me 20 shkollat dhe institucione parashkollore me qëllim të zhvillimit të projekteve të vogla hulumtuese për të kontribuar në avancimin e aktivitetit shkencor të personelit akademik në njërin anë dhe për të kontribuar në një sistem të vendimmarrjes së bazuar në të dhëna empirike në anën tjetër. Ky hap u vlerësua si qenësor për Fakultetin, për të qenë më afër realitetit në institucione arsimore si mundësi e mirë për të kuptuar nevojat e tregut të punës dhe për ta reflektuar këtë në përgatitjen më cilësore të mësimdhënësve të rinj. Temat të cilat u propozuan për hulumtime të përbashkëta me këto 20 shkollat ndërlidhen ngushtë me tematikat e Ekipeve të Hulumtimit të themeluara në fakultet kohëve të fundit.

IHZha së fundmi ka ndërmarrë edhe angazhim të shtuar në përkrahjen dhe koordinimin e nismave dhe projekteve zhvillimore. Kjo pritet të jetë ndihmesë për fakultetin dhe personelin për rritjen e numrit të projekteve zhvillimore dhe shkencore në periudhën vijuese. IHZha ka zhvilluar planin e vet të aktiviteteve në raport me ngritjen e bashkëpunimit të jashtëm dhe në raport me përkrahjen e brendshme të personelit për aktivitet të shtuar zhvillimor dhe shkencor.

3.5. Resurset njerëzore

Në fushën e kapaciteteve profesionale duhet të merren parasysh dy elemente. Së pari, faktor i rëndësishëm është numri i personelit të rregullt akademik, të cilët janë të nevojshëm për të akredituar dhe implementuar programet studimore. Dhe, së dyti sfidë në vete përbën edhe pamundësia e përcjelljes së trendeve të hulumtimeve në fushën e caktuar dhe pamundësia e një numri të stafit akademik për të përcjellë kërkesat e Agjencisë së Akreditimit për natyrën dhe profilin e publikimeve shkencore për të mirëmbajtur programet e caktuara, posaçërisht duke marrë parasysh se në 10 vitet e fundit fakulteti ka kaluar nga ofrimi i programeve baçelor në ofrimin e programeve kryesisht në nivelin master.

Në 10 vitet e fundit mundësitë për rekrutim të stafit të ri akademik kanë qenë më të limituara dhe fokusi është vënë më shumë në avancimin e asistentëve në vend të profesorëve të pensionuar, dhe fatkeqësisht nuk kanë arritur të bëhen të gjitha zëvendësimet e të gjitha pensionimeve, qoftë për arsye financiare apo edhe për mungesë të kuadrove në fushat përkatëse. Proporcioni personel akademik-studentë në fakultet mbetet ende sfidë (afërsisht 55 studentë në raport me 1 staf akademik) dhe ky realitet e ngarkon funksionimin e mirëfilltë të fakultetit dhe sfidon iniciativat për reforma më thelbësore në fakultet duke pamundësuar mbulimin adekuat të programeve me mësimdhënës të profilit të caktuar dhe duke kufizuar kohën e personelit për hulumtime shkencore. Për më shumë, një situatë e tillë ka shkaktuar edhe ngarkesë të shtuar të personelit në mentorimin e temave të masterit, në mësimdhënie, vlerësim formues, etj.

Aktualisht, analizat tregojnë se në vitin akademik 2021-2022, stafi akademik është i stërngarkuar me orë mësimore, që në një rëndësi anë ndikon në cilësinë e mësimdhënies, e në anën tjetër cenon edhe kohën e nevojshme për aktivitete kërkimore dhe profesionale. Megjithatë stërngarkimin e stafit akademik të rregullt me orë mësimore, edhe afro 230 orë mësimore (ligjërata dhe ushtrime) mbulohe nga bashkëpunëtorë të jashtëm (brenda dhe jashtë UP-së), gjë që jep një pasqyrë të qartë të nevojave për zhvillime kadrovike në të ardhmen. Kjo duhet të jenë indikacion i prioritetizimit të pozitivave në konkurset e reja për staf akademik. Po ashtu, duhet të kihet parasysh edhe vërejtjet e ekspertëve të akreditimit në vitin 2021 lidhur me mbingarkesën e stafit me shumë orë mësimi dhe kjo duhet të adresohet në dy vitet në vijim. Po ashtu, nevoja e kalimit nga ekspertiza gjenerike drejt asaj më specifike (që adresohet përmes rekrutimeve të reja) është jashtëzakonisht e rëndësishme për Fakultetin e Edukimit për të qenë në gjendje të ushtrijë misionin e vet në mënyrë të duhur edhe në mësimdhënie edhe në zhvillim të shkencës. Përveç kësaj, rritja e stafit akademik në Fakultetin e Edukimit duhet të shihet edhe nga perspektiva e nevojës për fuqizimin e inovacioneve në fushën e përgatitjes së mësimdhënësve dhe në sistemin shkollor, duke adresuar edhe nevojat prioritare të zhvillimit në sistem. Ndaj, zhvillimi i politikave kadrovike në Fakultet të Edukimit duhet të trajtohet bazuar në këto nevoja të dukshme, si dhe nga perspektiva e sigurimit të stabilitetit në ofrim të programeve dhe në raport me reagimin ndaj nevojave të tregut për programet ekzistuese dhe zhvillimin e programeve të reja.

Fakulteti i Edukimit është përballuar me sfidën e sigurimit të kuadrove të profileve që kërkoheshin me ndryshimet e vazhdueshme programore. Universiteti i Prishtinës nuk ka ofruar mundësi deri tani që të realizohen studime të doktoratës në fushën e didaktikës lëndore dhe kjo ka qenë një nga sfidat

kryesore të funksionimit të mirëfilltë të sistemit të shkollimit të mësimdhënësve të rinj. Po ashtu, ka pasur mungesë edhe të studimeve të fushës së edukimit të përgjithshëm në nivel të doktoratës në Kosovë. Për më shumë, ofrimi i programeve në fusha të ndryshme të specializimit lëndor dhe fushës së përgjithshme të arsimit kërkon edhe nevojën e zhvillimit të asaj fushe si fushë hulumtimi/studimi përveç mësimdhënies në atë fushë. Andaj, në realitetin e tanishëm, sfida në vete është përcjellja e trendeve nga personeli akademik në zhvillimet që ndodhin në shkencën e edukimit dhe standardet e profesionit të mësuesisë në realitetin post-modern, ndërsa realiteti i tanishëm në aktivitetin shkencor (publikime, përcjellja e konferencave shkencore, etj) duhet të ndryshohet duke synuar thellimin në studimin e arsimit më shumë sesa fushës së caktuar akademike.

3.6. Menaxhimi, administrata dhe infrastruktura

Administrata e fakultetit është e stërngarkuar në raport me numrin e studentëve dhe ndryshimet e shpeshta në programet studimore. Mungesa e resurseve njerëzore ka paraqitur me vite vështirësi të theksuara në administrimin e suksesshëm të shërbimeve cilësore për studentët. Fakulteti i Edukimit në vazhdimësi ka bërë identifikimin e vështirësive dhe ka dizajnuar procese specifike për të adresuar ato. Megjithatë, resurset vazhdojnë të jenë të mangëta në proporcion me vëllimin e punës që ka administrata. Në të kaluarën sistemi i administratës në fakultet ka funksionuar në bazë të rregullimit dhe normimit që është bërë nga niveli qendror i universitetit. Ndërsa, në nivel praktik të zbatimit, funksionimi ka qenë më shumë i drejtuar nga praktikat që janë formësuar në mënyrë konvencionale. Në vitet e fundit janë bërë disa veprime për të rregulluar funksionimin e procedurave dhe proceseve administrative në mënyrë të caktuar me idenë e qartësimit të proceseve për të gjitha palët. Nevoja është për zhvillim të mëtejshëm të pakove administrative dhe menaxheriale për të rritur efikasitetin e administrimit të proceseve në fakultet. Në këtë kuptim, synohet të bëhet analiza të funksionalitetit të shërbimeve administrative si dhe ndarja e roleve dhe përgjegjësive midis akterëve të ndryshëm brenda një shërbimi, si dhe definimi i modaliteteve funksionale të bashkëpunimit midis palëve të ndryshme. Kjo me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimeve për studentë, ndarjes së qartë të roleve dhe përgjegjësive si dhe rritjes së efikasitetit të shërbimeve administrative për studentët dhe stafin akademik. Në këtë kuptim, do të jetë e nevojshme edhe shqyrtimi i nevojave për kushtet e punës dhe mundësitë për zhvillim profesional për personelin e administratës.

3.6.1. Struktura e departamenteve

Nga tetori 2020, Fakulteti i Edukimit ka funksionalizuar një strukturë të re të organizimit të brendshëm me qëllim të rritjes së efektshmërisë, efikasitetit dhe koherencës në funksionim të institucionit. Kjo strukturë organizative synon lehtësimin dhe efikasitetin e proceseve administrative në një anë duke synuar decentralizimin e vendimmarrjes në nivel departamenti dhe në anën tjetër synon rritjen e bashkëpunimit kolegjal. Në nivel të dekanatit, përgjegjësitet janë të ndara midis tre prodekanëve, ndërsa në nivel të departamenteve, Fakulteti i Edukimit është i organizuar për një kohë më të gjatë në departamente që në vete kanë një numër programesh, si vijon:

1. Departamenti i edukimit parashkollor

Ky departament ka pasur dy programe për përgatitjen e edukatorëve të ndarë sipas moshave 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç. Në vitin 2021, është akredituar vetëm një program i quajtur Edukimi në fëmijërinë e hershme, i cili integron këto dy grup-mosha dhe edukatorët përgatiten për të punuar me fëmijët 0- 6 vjeç.

2. Departamenti i edukimit fillor

Në këtë departament funksionon programi për përgatitjen e mësimitdhënësve, të cilët punojnë me nxënësit e klasave 1-5 dhe në këtë fazë është duke u realizuar një studim fizibiliteti për hapjen e një programi Master njëvjeçar, i cili do t'u ofrohej studentëve të këtij programi, të cilët kanë interesim për kualifikim më të lartë si nevojë e zhvillimit profesional të vazhdueshëm.

3. Departamenti i mësimitdhënies lëndore

Programet e studimit në këtë departament janë: specializimet e mësimitdhënies lëndore: mësimitdhënia e gjuhës dhe letërsisë shqipe; mësimitdhënia e historisë; mësimitdhënia e gjeografisë; mësimitdhënia e matematikës; mësimitdhënia e teknologjisë dhe TIK; mësimitdhënia e kimisë; mësimitdhënia e fizikës; dhe mësimitdhënia e biologjisë.

4. Departamenti i pedagogjisë

Programet e studimit në këtë departament janë: Programi Master i Shkencave të Edukimit, me specializimin në: Edukim inkluziv; Udhëheqja arsimore; Mësimitdhënia dhe kurrikula; Këshillimi pedagogjik; dhe Programi Baçelor i Pedagogjisë.

3.6.2. Infrastruktura dhe qasja në burimet e mësimit

Fakulteti e ka bibliotekën e vet. Rreth 300 tituj të ri të librave janë siguruar në 5 vitet e fundit përmes projekteve TEMPUS dhe Erasmus nga Bashkimi Evropian, ndërsa në nivel të universitetit nuk ka ekzistuar një fond për të siguruar tituj shtesë. Qasja në resurset elektronike si databazat e revistave shkencore dhe librat elektronik vazhdon të mbetet e kufizuar. Universiteti ka qasje në databazën ScienceDirect si burim i vetëm i literaturës shkencore, e cila është më e kufizuar në numrin dhe volumin e punimeve që sigurohen përmes saj.

Ndërtesa e Fakultetit është relativisht e re dhe në gjendje të mirë. Me sipërfaqe prej 6,315 m², ofron hapësirë të mjaftueshme dhe kushte optimale për punën e Fakultetit. Fakulteti posedon disa laboratorë për punën praktike dhe simulimin e mësimitdhënies me studentët e nivelit Ba dhe Ma. Megjithatë, janë disa mangësi nga aspekti i infrastrukturës që duhet të adresohen, si: mosfunksionimi i duhur i pajisjeve të teknologjisë informative si projektorët, laboratorët e vjetërsuar të shkencave që nuk mund të vihen plotësisht në funksion të zhvillimit të mësimit, mungesa e teknologjisë moderne për demonstrim të mësimit për ta bërë atë më konkret dhe mësimitdhënien më interaktive.

4. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

4.1. Vizioni i Fakultetit të Edukimit

Fakulteti i Edukimit si ofruer i arsimit bashkëkohor synon të zhvendos fokusin nga sasia drejt cilësisë dhe ndjekjes së qëllimeve strategjike në aktivitetet e mësimdhënies inovative dhe kërkimit shkencor. Duke iu përgjigjur në mënyrë fleksibile ndryshimeve dinamike shoqërore dhe ekonomike, fakulteti zhvillon strategji të reja që promovojnë të nxënit gjatë gjithë jetës, të cilat synojnë zhvillimin e potencialit maksimal të secilit individ për të qenë kontribuues aktiv në profesion dhe në shoqëri.

Fakulteti i Edukimit synon të luaj një rol kyç në zhvillimin e politikave të bazuara në hulumtime dhe të dhëna që shërbejnë për vendimmarrje të orientuar në ndryshime arsimore që do të ngrisin cilësinë e jetës së qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, vizioni i Fakultetit të Edukimit është:

Fakulteti i Edukimit, institucion udhëheqës në Kosovë për përgatitjen e mësimdhënësve dhe profesionistëve arsimor, kompetentë në zbatimin e praktikave inovative të mësimdhënies, të nxënit dhe kërkimit që synojnë zhvillimin e potencialit maksimal të secilit individ në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit dhe në përputhje me trendet e zhvillimit global.

4.2. Misioni i Fakultetit të Edukimit

Në aktivitetet e mësimdhënies dhe të nxënit, Fakulteti i Edukimit i përgjigjet trendeve më të reja si në përmbajtje ashtu edhe në metodologji, në të gjitha nivelet e arsimit, dhe është në gjendje t'i adaptohet ndryshimeve të vazhdueshme legjislative dhe shoqërore që prekin profesionin e mësimdhënësit dhe profesionet e tjera të edukimit.

Fakulteti i Edukimit ofron programe për zhvillim të vazhdueshëm profesional për të përmbushur nevojat e mësimdhënësve për ngritje dhe avancim të mëtejshëm profesional, apo për shkathtësi të veçanta sipas nevojave dhe interesave të tyre. Në aktivitetet e veta kërkimore, fokusi kryesor i Fakultetit është në mbështetjen e ekipeve të hulumtimit që punojnë në fusha të lidhura ngushtë me qëllimet e Fakultetit. Në vazhdimësi investohet në ngritjen e kapaciteteve të stafit akademik për të ngritur cilësinë e hulumtimeve shkencore.

Një nga fushat kryesore të fokusit të fakultetit është zhvillimi i lidhjeve të forta me institucionet edukative dhe arsimore në vend, por edhe me ato ndërkombëtare, si në mësimdhënie ashtu edhe në kërkim. Gjithashtu, fakulteti mbështetë në mënyrë aktive mobilitetin e studentëve dhe stafit (përfshirë stafin akademik dhe joakademik), duke punuar së bashku me një sërë institucionesh partnere në Evropë dhe më gjerë për të organizuar shkëmbime studentore si dhe për të kultivuar lidhje kërkimore nëpërmjet projekteve të përbashkëta. Fakulteti zgjeron vazhdimisht numrin dhe llojet e kurseve dhe moduleve të ofruara në gjuhën angleze për të qenë atraktiv edhe për studentët e Universiteteve të tjera rajonale dhe më gjerë.

Fakulteti i Edukimit luan një rol aktiv në jetën publike dhe në debatet aktuale, duke ndihmuar në promovimin e vlerave dhe praktikave që drejtojnë zhvillimin e politikave dhe kontribuojnë në ndërgjegjësimin e qytetarëve për edukim cilësor. Si institucion publik, është partner strategjik i rëndësishëm në politikën arsimore dhe është i përfshirë në formulimin dhe zbatimin e politikave arsimore në nivel shteti.

Rrjedhimit, misioni i Fakultetit të Edukimit është ofrimi i programeve cilësore për përgatitjen dhe aftësimin e vazhdueshëm të edukatorëve, mësimdhënësve dhe specialistëve të tjerë në fushën e edukimit, zhvillimi i veprimtarisë kërkimore-shkencore, dhe rrjetëzimi në komunitet, në funksion të avancimit të sistemit të orientuar në nevojat e shoqërisë, në edukim cilësor dhe në zhvillim të njohurive, shkathtësive dhe vlerave në shoqëri.

4.3. Vlerat

Vlerat mbi të cilat ndërtohet misioni dhe synohet vizioni i Fakultetit të Edukimit, janë:

Përsosmëria dhe inovacioni

Ne jemi të përkushtuar për përsosmëri në çdo proces akademik duke ofruar mësimdhënie inovative, hulumtime shkencore që i shërbejnë komunitetit dhe bashkëveprim me komunitetin. Jemi të dedikuar në përmirësim të vazhdueshëm dhe udhëheqje të zhvillimeve inovative në politikë-bërjen dhe zhvillimin e sistemit të arsimit parauniversitar në Kosovë!

Etika dhe integriteti akademik

Ne jemi të përkushtuar ndaj standardeve më të larta të ndershmërisë, drejtësisë, respektit dhe etikës profesionale dhe akademike. Ne vlerësojmë dinjitetin dhe vlerën e të gjithë njerëzve. Ne presim që e gjithë sjellja jonë të bazohet në integritet, respekt të ndërsjellë dhe qytetari demokratike. Kjo sjellje drejtohet nga standardet më të larta etike.

Fokusi tek studenti

Ne jemi të përkushtuar për të nxitur ngritjen profesionale dhe personale të të gjithë studentëve tanë duke promovuar të mësuarit gjatë gjithë jetës, zhvillimin e kompetencave dhe kolegjalitetin. Interesat dhe nevojat e studentëve janë fokusi kryesor i të gjitha vendimeve dhe aktiviteteve të Fakultetit të Edukimit.

Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi

Ne angazhohemi të punojmë në mënyrë kolegjinale dhe bashkëpunuese në krijimin e partneriteteve produktive me kolegjet, universitetin, institucionet qeveritare, institucionet e arsimit parauniversitar, organizatat jofitimprurëse dhe komunitetin. Nëpërmjet këtyre partneriteteve, ne përpiqemi të përmirësojmë arsimin për të gjithë për të siguruar një të ardhme më të mirë.

Fuqizimi

Ne vlerësojmë, respektojmë dhe dëgjojmë perspektiva të shumta dhe ftojmë studentët, mësime dhe partnerët e komunitetit që të përdorin zërat e tyre për të avancuar mirëkuptimin tonë të përbashkët dhe për të drejtuar përpjekjet tona kolektive për të përmirësuar rezultatet e arsimit.




FIGURA 1. VLERAT MBI TË CILAT NDËRTOHET MISIONI DHE VIZIONI I FAKULTETIT TË EDUKIMIT

5. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Fakulteti i Edukimit në procesin e planifikimit strategjik për periudhën pesë vjeçare 2022-2026 ka përcaktuar objektiven e përgjithshme strategjike dhe katër objektivat specifike, të cilat përveç që ndërlidhen ngushtë njëra me tjetrën, kanë për synim zhvillimin e një sistemi të qëndrueshëm të mekanizmave për sigurim të cilësisë me bazë në fakultet, në përputhje me mekanizmat qendrore të sigurimit të cilësisë në nivel universiteti dhe vendi.



FIGURA 2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË FAKULTETIT TË EDUKIMIT

5.1. Përshkrimi i objektivës së përgjithshme strategjike

Grupi punues, ka analizuar situatën e tanishme të arsimit parauniversitar dhe përveç problemeve të shumta që ndërlidhen me faktorë të ndryshëm që nuk kanë të bëjnë me fakultetin njëri nga problemet kyçe ka të bëjë me vet cilësinë e mësimdhënies apo përgatitjen e mësimdhënësve para dhe në shërbim. Kështu, është konstatuar se ekziston:

Niveli jo i kënaqshëm i cilësisë së përgatitjes së mësimdhënësve dhe profesionistëve tjerë arsimor, që ndikon në kapacitetet dhe kompetencat e tyre për të udhëhequr ndryshimet në sistemin shkollor, dhe mungesë e qasjes së mësimdhënies së bazuar në kërkime shkencore dhe relevante për realitetin e profesionit të mësuesisë në nivel vendi dhe në kontekst ndërkombëtar; Mbi bazën e këtij problemi kyç, është përcaktuar objektiva kryesore strategjike e Fakultetit të Edukimit e cila konkretizohet me 4 objektiva të tjera specifike.

Objektiva strategjike e përgjithshme: Kulturë organizative e zbatimit të programeve bazuar në standardet e cilësisë dhe profesionit, që reflekton mësimdhënien e bazuar në kërkim shkencor, në funksion të zhvillimit të mësimdhënies cilësore si mjet për ndryshimin e realitetit të mësimdhënies dhe mësimnxënies në institucionet edukative.

Analiza e gjendjes për praktikën e sigurimit të cilësisë e cila u realizua në kuadër të projektit QATEK, në vitin 2020, tregoi se procesi i akreditimit konsiderohet si kornizë udhëzuese për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe përgatitjen e mësimdhënësve (QATEK, 2020). Edhe pse procesi i akreditimit ka ndikuar në zhvillimin e mekanizmave të brendshëm (institucionalë) për sigurim të cilësisë nëpër institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve para-shërbimit, akreditimi është i orientuar nga jashtë dhe drejtohet nga tregues sasiore. Për pasojë, standardet dhe treguesit e performancës për sigurimin e jashtëm të cilësisë nuk mund të përgjithësohen si përmirësim i cilësisë në tërë procesin e përgatitjes së mësimdhënësve. Institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve para-shërbimit kanë nevojë për tregues/standarde të përshtatshme (si cilësore ashtu edhe sasiore) kur synojnë të zhvillojnë përgatitje të mësimdhënësve të orientuar drejt cilësisë, dhe të sigurojnë profesionalizmin e mësimdhënësve të ardhshëm. Në këtë mënyrë, palët e brendshme të interesit mund të komunikojnë më mirë me standardet dhe udhëzimet e brendshme për përmirësimin e cilësisë dhe të ofrojnë angazhim përbajtësor drejt zhvillimit të një kulture të cilësisë në kuadër të institucioneve.

Analiza e gjendjes për programet për përgatitje të mësimdhënësve para-shërbimit (2020) konfirmon se njohuritë dhe shkathtësitë e lidhura me mësimnxënien dhe mësimdhënien janë më pak të zhvilluara, dhe roli i përgatitjes së mësimdhënësve është i konceptuar më ngushtë se që realisht duhet të jetë. Gjetjet nga analiza e gjendjes për zbatim të programeve tregojnë se zhvillimi i njohurive është

prioritet në programet e përgatitjes së mësimitdhënësve. Shkathtësitë synohen të zhvillohen kryesisht gjatë periudhës së praktikës dhe zhvillimi i shkathtësive duket se nuk është prioritet në programe. Në anën tjetër, zhvillimi i qëndrimeve, besimeve dhe vlerave për profesionin e mësimitdhënësit, është komponenti më së paku i adresuar i programeve.

Duke u bazuar në këto të dhëna dhe pas analizës SWOT dhe PEST u identifikuan objektiva kryesore strategjike që për synim kanë zhvillimin e kulturës organizative të zbatimit të programeve bazuar në standardet e cilësisë dhe profesionit, që reflekton mësimitdhënien e bazuar në kërkim shkencor, në funksion të zhvillimit të mësimitdhënies cilësore si mjet për ndryshimin e realitetit të mësimitdhënies dhe mësimitdhënies në institucionet edukative.

Treguesit e ndikimit:

- Politika, standardet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë zbatohen dhe përdoren si bazë për vendimmarrje në proceset që ndërlidhen me mësimitdhënie, të nxënë, kërkim shkencor dhe bashkëpunim vendor dhe ndërkombëtar.
- Rritet numri i publikimeve shkencore të integruara ndërdisciplinare dhe hulumtimi shkencor është integruar në procesin e mësimitdhënies dhe të nxënës.
- Zbatohen metoda inovative të mësimitdhënies dhe vlerësimit të vazhdueshëm dhe studenti është pjesëmarrës aktiv në procesin e të nxënës.
- Zbatohen projekte të përbashkëta me institucionet arsimore me qëllim të ofrimit të programeve të përgatitjes së mësimitdhënësve bazuar në nevojat e tregut të punës.

Objektiva e përgjithshme strategjike realizohet përmes katër objektivave specifike të ndërlidhura me treguesit e ndikimit, të kategorizuara si më poshtë:

1. Mësimitdhënia dhe të nxënës
2. Hulumtimi, invacioni dhe ndërkombëtarizimi
3. Administrimi dhe menaxhimi
4. Rrjetëzimi komunitar dhe partneriteti.

Ndërsa, sigurimi i cilësisë është komponentë e integruar në kuadër të secilës objektivë specifike.



5.2. Përshkrimi i objektivës specifike 1: Mësimdhënia dhe të nxënit

Problemi kyç 1: Zbatimi i pamjaftueshëm i metodave inovative të mësimdhënies dhe të nxënit dhe mungesa e një sistemi të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë për të monitoruar zbatimin e programeve që synojnë ndërlidhjen e teorisë me punën praktike dhe të nxënit përmes hulumtimit shkencor, vlerësimin e vazhdueshëm, përdorimin e resurseve mësimore dhe teknologjike si dhe bashkëpunimin kolegjal dhe ndërdisiplinarë.

Objektiva specifike 1: MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT

Zhvillimi i praktikave inovative të mësimdhënies, të nxënit dhe vlerësimit, fuqizimi i bashkëpunimit kolegjal dhe ndërdisiplinarë dhe ndërlidhja e teorisë me praktikën dhe hulumtimin shkencor përmes zbatimit të mekanizmave të qëndrueshëm dhe të matshëm të sigurimit të cilësisë ashtu që studentët të marrin përvoja cilësore që i kontribuojnë zhvillimit dhe rritjes së tyre personale dhe profesionale e cila reflektohet në punën e tyre në institucione edukative.

Përvojat e mësimdhënies dhe të nxënit gjatë përgatitjes së mësimdhënësve para shërbimit, ndërlidhen pozitivisht me praktikën e mësimdhënies qysh në fazat fillestare të angazhimit të mësimdhënësve dhe tutje gjatë përvojës në shërbim. Fakulteti i Edukimit synon që të zhvillojë praktika inovative të mësimdhënies, të nxënit dhe vlerësimit, të cilat e vënë studentin në qendër duke e zhvendosur atë nga pozita e dëgjuesit pasiv në pjesëmarrës aktiv që nga faza e planifikimit e deri tek vlerësimi i diturive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve, por edhe përfshirjes në hulumtime shkencore arsimore. Përpos kësaj, i tërë procesi synohet të përcillet përmes mekanizmave për sigurimin e cilësisë duke marrë në konsideratë mendimet e studentëve dhe akterëve të tjerë për të gjitha proceset qoftë akademike apo administrative që zhvillohen në fakultet. Kjo objektivë do të zhvillohet tutje përmes stimulimit të bashkëpunimit kolegjal dhe ndarjes së përvojave në mësimdhënie dhe hulumtime shkencore.

Treguesit e rezultateve:

- Politika e sigurimit të cilësisë zbatohet në baza periodike.
- Kurset ofrohen përmes kombinimit të metodave inovative të mësimdhënies dhe vlerësimit ku studenti është aktiv në të nxënë, në zhvillim të kompetencave, shkathtësive dhe vlerave.
- Hulumtimi është pjesë integrale e studimeve në lëndë të ndryshme të programeve për përgatitjen e mësimdhënësve dhe specialistëve të tjerë të edukimit.
- Vlerësimi formues dhe përmbledhës janë praktikë e rregullt dhe e dokumentuar dhe nuk fokusohen vetëm në matjen e dijeve por edhe të shkathtësive dhe vlerave të studentëve

5.2.1. Rezultatet, aktivitetet dhe treguesit për objektivën specifike 1

Grupi punues, për secilën objektivë strategjike ka planifikuar rezultate të matshme të cilat pritet të realizohen përmes aktiviteteve specifike që dëshmojnë me tregues përkatës.

Në vijim janë prezantuar aktivitetet dhe treguesit e produktit për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme për objektivën e parë specifike.

Rezultati 1. Politika e sigurimit të cilësisë zbatohet në baza periodike.	
Aktivitetet:	Treguesit e produktit:
1.1. Zbatimi i instrumenteve të politikës për sigurimin e cilësisë, duke u bazuar në tregues të matshëm, në nivel të programeve dhe kurseve duke përfshirë vlerësimin e programeve dhe kurseve në përputhje me politikën e sigurimit të cilësisë	<ul style="list-style-type: none"> - Është zbatuar politika dhe instrumentet për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet. - Është realizuar vlerësimi dhe është hartuar plani për përdorimin e të dhënave të dala nga vlerësimi. - Janë përgatitur planet e veprimit për përmirësim.
1.2. Komunikimi i rregullt i rezultateve të vlerësimit të kurseve dhe vlerësimit periodik të programeve tek stafi akademik;	<ul style="list-style-type: none"> - Stafit akademik i është dorëzuar raporti i vlerësimit të kursit/eve nga ana e studentëve.
1.3. Lidhja e vlerësimit të kurseve me mekanizmin e 'shqyrtimit të performancës së stafit akademik' në përputhje me politikën e sigurimit të cilësisë të miratuar në fakultet.	<ul style="list-style-type: none"> - Janë përgatitur plane të individualizuara të zhvillimit profesional për secilin anëtar stafi akademik, bazuar në formularin e vlerësimit. - Janë zhvilluar intervista të përshtatura me secilin anëtar të stafit akademik të paktën një herë në vit, për të shqyrtuar planet dhe identifikuar aktivitetet prioritare për zhvillim.
1.4. Analiza e profilit të stafit akademik dhe identifikimi i nevojave për kuadro për konkurset e ardhshme.	<ul style="list-style-type: none"> - Janë realizuar në vazhdimësi analizat e përshtatshmërisë së profileve me lëndët/ programin studimor dhe shërbejnë si bazë për vendimmarrje.
1.5. Reformimi i praktikës pedagogjike me synim përkrahjen e studentëve në zhvillimin e shkathtësive të transferueshme dhe njohjen me të	<ul style="list-style-type: none"> - Janë rishikuar doracakët e praktikave pedagogjike për të gjitha nivelet dhe janë planifikuar saktë rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë akterëve të

<p>gjitha specifikat e realitetit të punës së mësimdhënësit.</p>	<p><i>përfshirë në praktikën pedagogjike.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Janë organizuar seminare dhe takime të rregullta të punës me profesorët dhe asistentët e angazhuar në implementimin e mësimit praktik për të analizuar gjendjen e tanishme dhe për të identifikuar përmirësimet;</i> - <i>Janë mbledhur komente kthyese në baza të rregullta nga studentët për përvojën e tyre në mësim praktik për të identifikuar fushat për përmirësim;</i> - <i>Janë organizuar trajnimet për mësimdhënësit mentor për mentorim cilësor të studentëve.</i>
<p>1.6. Fuqizimi i ZZHA për të zbatuar politikën për sigurimin e cilësisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Zyra për Zhvillim Akademik, implementon proceset e monitorimit, regjistrimit dhe vlerësimit të të dhënave të grumbulluara përmes instrumenteve të sigurimit të cilësisë.</i> - <i>Janë hartuar raporte të rregullta pas çdo procesi të mbledhjes së komenteve kthyese nga palët e përfshira</i>
<p>Rezultati 2. Kurset ofrohen përmes kombinimit të metodave inovative të mësimdhënies dhe vlerësimit ku studenti është aktiv në të nxënë, në zhvillim të kompetencave, shkathtësive dhe vlerave</p>	
<p>1.7. Hartimi i udhëzuesve për përgatitje të syllabuseve që reflektojnë parimet e implementimit të kurseve/lëndëve që janë të orientuara drejt mësimdhënies më studentin në qendër, të mësuarit e bazuar në kërkim (ang: inquiry based learning), mësimi të individualizuar dhe diferencuar, zbatimit të teknologjisë në mësim dhe të mësuarit aktiv.</p>	<ul style="list-style-type: none"> - <i>Janë hartuar udhëzuesit për përgatitjen e syllabuseve që reflektojnë edhe parimet e mësimdhënies së bazuar në kërkim të informacionit dhe të orientuar në praktikë.</i> - <i>Janë përgatitur modele të planeve mësimore që pasqyrojnë procesin e mësimdhënies dhe të nxënës në ndërlidhje me rezultatet e pritshme dhe këto janë në linjë edhe me metodat e vlerësimit të studentëve.</i> - <i>Syllabuset e lëndëve reflektojnë parimet e mësimi të bazuar në kërkim, mësimin e individualizuar dhe të mësuarit aktiv.</i> - <i>Syllabuset e lëndëve reflektojnë parimet e mësimi të diferencuar dhe individualizuar.</i> - <i>Syllabuset e lëndëve reflektojnë</i>

		<i>praktikat e zbatimit të teknologjisë në mësimdhënien në lëndë, programe dhe nivele të ndryshme të studimit.</i>
1.8. Zhvillimi i proceseve dhe mekanizmave për ndarjen e praktikave të mira të implementimit të syllabuseve dhe shkëmbimit të përvojave mes kolegëve.	-	<i>Është hartuar plani vjetor për diskutimin e syllabuseve dhe janë mbajtur takimet e parapara.</i> - <i>Departamentet kanë mbajtur takime periodike para fillimit të semestrit për të diskutuar implementimin e syllabuseve dhe për të ndarë përvojat e mira;</i> - <i>Një pjesë e stafit akademik ka filluar zbatimin e observimit të ndërsjellë dhe ka përpiluar planin personal për avancim të praktikave të mësimdhënies.</i>
1.9. Rishikimi dhe reformimi i syllabuseve duke reflektuar çështjet e inovacionit në mësimdhënie dhe mësimnxënie dhe planifikimin koherent të kurseve dhe programeve.	-	<i>Janë organizuar seminare për mësimdhënien inovative në arsimin e lartë dhe inovacionet në profesionalizmin e mësimdhënësve.</i> - <i>Rishikimi i programeve reflekton një koherencë dhe planifikim të qëllimshëm për adresimin e koncepteve relevante arsimore.</i>
Rezultati 3: Hulumtimi është pjesë integrale e studimeve në lëndë të ndryshme të programeve për përgatitjen e mësimdhënësve dhe specialistëve të tjerë të edukimit		
1.10. Integrimi i aktiviteteve të cilat bazohen në kërkime shkencore në kuadër të syllabuseve të lëndëve të ndryshme dhe jo vetëm në lëndët e parapara enkas për hulumtimin shkencor.	-	<i>Janë rishikuar syllabuset dhe janë integruar hulumtimet shkencore si pjesë e studimeve në lëndë të ndryshme si dhe janë përfshirë aktivitete të studentëve që zhvillojnë aftësinë e tyre për kërkim dhe përpunim të informacionit.</i>
Rezultati 4: Vlerësimi formues dhe përmbledhës janë praktikë e rregullt dhe e dokumentuar dhe nuk fokusohen vetëm në matjen e dijeve por edhe të shkathtësive dhe vlerave të studentëve.		
1.11. Vlerësimi i studentëve në mënyrë të vazhdueshme duke përdorur forma të ndryshme të vlerësimit përfshirë atë përmbledhës dhe formues dhe dokumentimi i këtyre vlerësimeve nga ana e stafit akademik.	-	<i>Studentët janë vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme dhe kjo mund të dokumentohet nga vlerësimet që studentët ia bëjnë kurseve në fund të secilit semestër.</i> - <i>Takimet kolegjiale për shqyrtim të syllabuseve rezultojnë në rishikimin e syllabuseve për të reflektuar metodat e vlerësimit të vazhdueshëm.</i>

5.3. Përshkrimi i objektivës specifike 2: Hulumtimi, inovacioni dhe ndërkombëtarizimi

Problemi kyç 2: Numër i vogël i hulumtimeve në fushën arsimore dhe i hulumtimeve të integruara dhe ndërdisiplinare; procedura të pastrukturuara të sigurimit të etikës në hulumtimet shkencore; angazhim i ultë i studentëve në punën hulumtuese; nivel jo i kënaqshëm i pjesëmarrjes në mobilitete ndërkombëtare.

Objektiva specifike 2: HULUMTIMI, INOVACIONI DHE NDËRKOMBËTARIZIMI

Avancimi në hulumtime shkencore përmes promovimit të hulumtimeve të integruara, përfshirjes së studentëve në hulumtime shkencore dhe mobilitete ndërkombëtare, rritjes së bashkëpunimit në projekte kombëtare duke krijuar partneritet me shkolla dhe institucione parashkollore dhe në projekte ndërkombëtare, dhe zhvillimit të programeve të integruara konform nevojave të tregut të punës.

Si rrjedhojë e numrit të vogël të hulumtimeve të integruara dhe ndërdisiplinare në fushën arsimore, Fakulteti i Edukimit synon ndërtimin e një sistemi që nxitë bashkëpunimin kolegjal në hulumtime të integruara arsimore përmes funksionalizimit të ekipeve hulumtuese të ndërlidhura në tematika sipas interesit dhe orientimit të stafit akademik, duke përfshirë edhe studentët e të gjitha niveleve, por edhe ndërlidhjen dhe bashkëpunimin me shkollat dhe institucionet e tjera edukative- arsimore në vend duke i bërë edhe komunitetin arsimor partner në hulumtime të përbashkëta. Gjithashtu, Fakulteti i Edukimit synon të vazhdojë të zhvillojë projekte ndërkombëtare për të bashkëpunuar me Universitete të njohura në fushën e arsimit me qëllim të rritjes së bashkëpunimit në hulumtime shkencore dhe realizimit të mobiliteteve si për stafin akademik ashtu edhe për studentët.

Treguesit e rezultateve:

- Rritet numri i publikimeve të hulumtimeve të integruara shkencore në fushën e edukimit si rezultat i funksionalizimit të ekipeve hulumtuese dhe bashkëpunimit kolegjal brenda fakultetit;
- Funksionalizohen partneritetet me shkollat dhe institucionet parashkollore për bashkëpunim në projekte hulumtuese;
- Lëndët përmbajnë komponentë hulumtuese për të zhvilluar kompetencat e studentëve për kërkim shkencor;
- Zhvillohen dhe akreditohen programet e integruara MA në gjuhën angleze;
- Rritet pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në mobilitete ndërkombëtare;
- Zhvillohen dhe zbatohen projektet e përbashkëta kërkimore me partnerë ndërkombëtar.

5.3.1. Rezultatet, aktivitetet dhe treguesit për objektivën specifike 2

Në vijim janë prezantuar aktivitetet dhe treguesit e produktit për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme për objektivën e dytë specifike.

Rezultati 1: Rritet numri i publikimeve të hulumtimeve të integruara shkencore në fushën e edukimit si rezultat i funksionalizimit të ekipeve hulumtuese dhe bashkëpunimit kolegjal brenda fakultetit.	
Aktivitetet:	Treguesit e produktit:
2.1. Funksionalizimi i ekipeve hulumtuese	<ul style="list-style-type: none"> - Ekipet hulumtuese janë funksionale dhe takohen rregullisht; - Ekipet hulumtuese kanë përpiluar dhe zbatuar agjendën hulumtuese dhe planet një vjeçare. - Janë organizuar seminare dhe simpoziume për të prezantuar rezultatet e projekteve kërkimore.
2.2. Realizimi dhe shpërndarja e rregullt e rezultateve nga hulumtimet (platformë e fakultetit për të publikuar rezultatet e studimeve)	<ul style="list-style-type: none"> - Është rritur numri i hulumtimeve ndërdisiplinare; - Në web faqen e fakultetit janë publikuar përmbledhje të rezultateve të hulumtimeve të stafit akademik;
2.3. Publikimi i monografive shkencore të stafit akademik nga ekipe të ndryshme rreth tematikave të rëndësishme në arsim (përfshirë dhe studentët PhD).	<ul style="list-style-type: none"> - Janë publikuar monografi shkencore të dala nga bashkëpunimi i stafit në ekipet hulumtuese ku janë përfshirë edhe studentët e nivelit të doktoraturës
2.4. Administrimi i databazës për kontributin hulumtues të stafit akademik, projektet dhe mobilitetet ndërkombëtare.	<ul style="list-style-type: none"> - Është populluar dhe mirëmbajtur databaza për monitorimin e kontributit hulumtues të stafit akademik në hulumtime, projekte dhe mobilitete;
2.5. Organizimi i seminareve për promovim të punës shkencore, shkëmbimit kolegjal dhe angazhimit në projekte.	<ul style="list-style-type: none"> -Janë mbajtur seminare/webinare të rregullta për shpërndarje të gjetjeve shkencore nga hulumtimet e realizuara nga stafi akademik. -Janë mbajtur seminare me stafin akademik për shkëmbimin/shpërndarjen e njohurive nga angazhimi në projekte vendore dhe ndërkombëtare.
Rezultati 2. Funksionalizohen partneritetet me shkollat dhe institucionet parashkollore për bashkëpunim në projekte hulumtuese;	
2.6. Zhvillimi dhe implementimi i projekteve të hulumtimit në partneritet me shkollat mostër duke promovuar idetë inovative dhe duke	<ul style="list-style-type: none"> - Janë nënshkruar marrëveshjet me shkollat dhe institucionet parashkollore për bashkëpunim në zhvillimin e hulumtimeve.

testuar e zhvilluar koncepte relevante për sistemin e arsimit parauniversitar.

- Ekipet hulumtuese kanë implementuar projekte hulumtuese në partneritet me shkollat/institucionet parashkollore.

- Rezultatet e projekteve hulumtuese janë shkëmbyer në seminare, konferenca e forume të tjera.

Rezultati 3. Lëndët përmbajnë komponentë hulumtuese dhe praktike për të zhvilluar kompetencat e studentëve për kërkim shkencor

2.7. Analiza dhe rishikimi i syllabuseve me qëllim të integritit të qasjes së bazuar në hulumtime shkencore si metodë e të nxënës duke reflektuar ndërlidhjen midis teorisë dhe praktikës.

- Syllabuset janë rishikuar dhe janë integruar metoda të hulumtimit që synojnë përfshirjen e studentëve në kërkime shkencore gjatë studimeve në të gjitha nivelet.

- Studentët kanë reflektuar në vlerësimet e kurseve dhe programeve kënaqshmëri më të lartë me përvojën në punë kërkimore.

-Është reflektuar ndërlidhja midis njohurive, shkathtësive dhe vlerave në rezultatet e të nxënës të planifikuara në syllabuse.

2.8. Hartimi i udhëzuesit për etikë në hulumtim për përcaktimin e hapave dhe standardeve të çështjeve etike në procesin e hulumtimit në edukim.

- Është dizajnuar udhëzuesi për çështje etike dhe integritet në hulumtimet arsimore dhe është publikuar në web faqen e fakultetit.

- Është formuar këshilli i etikës nga radhët e stafit akademik të fakultetit, i cili miraton aspektet etike të projekteve hulumtuese të studentëve.

2.9. Analiza periodike e punimeve të temave master me qëllim të rritjes së cilësisë së hulumtimeve të studentëve dhe lidhjes së tyre me prioritetet e fakultetit dhe profesionin e mësuesit.

- Janë identifikuar anët e forta dhe nevojat për përmirësim në temat master dhe janë orientuar studentët drejt temave që lidhen me prioritetet e FE dhe profesionin e mësuesit.

- Janë mbajtur takime pune rreth veprimeve që duhet ndërmarrë për të rritur cilësinë e punimeve master.

- Departamentet kanë hartuar instrumente dhe procedura përkatëse për të menaxhuar procesin e adresimit të gjetjeve të këtyre analizave.

Rezultati 4: Zhvillohen dhe akreditohen programet e integruara MA në gjuhën angleze;

2.10. Analiza për hapjen e programeve multidisiplinare konform nevojave të tregut vendor dhe ndërkombëtar (niveli BA, MA) dhe programeve PhD me institucionet

- Është kryer analiza e fizibilitetit për hapjen e programeve multidisiplinare në nivelin BA, MA dhe PhD.

- Është hartuar koncepti për ndërkombëtarizimin

ndërkombëtare dhe aplikimi për akreditim.	e programeve të studimit. - Është akredituar së paku një program BA, ose MA ose PhD në partneritet me institucione ndërkombëtare të Arsimit të lartë.
---	--

Rezultati 5. Rritet pjesëmarrja e stafit akademik dhe studentëve në mobilitete ndërkombëtare;

2.11. Zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar përmes mobiliteteve akademike.	<ul style="list-style-type: none"> - Është rritur numri i aplikimeve për mobilitete të stafit dhe studentëve në universitete ndërkombëtare - Është rritur numri i mobiliteteve nga profesorët vizitorë në programet e Fakultetit të Edukimit - Janë përgatitur dhe ofrohen 20 kurse në gjuhën angleze për studentët e huaj që aplikojnë në FEdu përmes programeve ERASMUS PLUS dhe të ngjashme - Është rritur numri i studentëve ndërkombëtar në programet e Fakultetit të Edukimit.
---	--

2.12. Promovimi i rregullt i mundësive/thirrjeve për projekte të përbashkëta.	- Janë shpërndarë rregullisht thirrjet për mundësi mobiliteti dhe për projekte tek stafi dhe studentët.
--	---

Rezultati 6. Zhvillohen dhe zbatohen projektet e përbashkëta kërkimore me partnerë ndërkombëtar

2.13. Rritja e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare (Horizon, Erasmus Plus Capacity Building, Jean Monnet Teacher Training; Strategic Partnership and Innovation, COST Action).	<ul style="list-style-type: none"> - Janë organizuar punëtori për përgatitjen e stafit akademik për hartimin dhe aplikimin në projekte ndërkombëtare. - Stafi akademik ka aplikuar në projekte ndërkombëtare relevante (Horizon, Erasmus Plus Capacity Building, Jean Monnet Teacher Training; Strategic Partnership and Innovation, COST Action) konform interesave të tyre profesionale - Është rritur në baza vjetore numri i projekteve kërkimore të dorëzuara dhe miratuara.
--	--

2.14. Organizimi vjetor i Konferencës Ndërkombëtare KICER.	<ul style="list-style-type: none"> - Konferenca KICER është organizuar në baza vjetore. - Janë publikuar abstraktet dhe punimet e përzgjedhura nga konferenca vjetore.
---	--

5.4. Përshkrimi i objektivës specifike 3: Rrjetëzimi komunitar dhe partneriteti

Problemi kyç 3: Ndërlidhje e dobët mes fakultetit dhe institucioneve edukative-arsimore, partneritete të mangëta me institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile, përfshirje e ultë në aktivitete të rrjetëzimit komunitar dhe të përgjegjësisë sociale si dhe përmbajtje të pakta programore që synojnë zhvillimin e ndërmarrësisë tek studentët.

Objektiva specifike 3: RRJETËZIMI KOMUNITAR DHE PARTNERITETI

Ndikim dhe kontribut i shtuar në komunitet përmes pjesëmarrjes së stafit dhe studentëve në projekte të përbashkëta zhvillimore dhe hulumtuese me institucionet arsimore, organizatat e shoqërisë civile dhe donatorët, rritje e ndërgjegjësimit dhe përgjegjësisë sociale përmes kontributit të drejtpërdrejtë në shërbime në komunitet si dhe rritje e përmbajtjeve programore që synojnë zhvillimin e ndërmarrësisë tek studentët.

Çështjet e cekura më lartë kërkojnë që fakulteti të angazhohet në drejtim të lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me shkollat dhe institucionet arsimore për të realizuar projekte të përbashkëta me qëllimin për të kuptuar realitetin, sfidat dhe kontekstin dhe për të përshtatur programet për të reflektuar këtë realitet dhe nevojat e tregut të punës. Gjithashtu, Fakulteti i Edukimit synon që përpos gatishmërisë për punë në institucione arsimore në pozitën e mësimdhënësit të zhvillojë tek studentët edhe vlerat e qytetarisë aktive dhe përgjegjshmërisë sociale përmes angazhimit në punë vullnetar dhe kontribut në programe komunitare, si dhe të formësojë shkathtësitë për zhvillimin e ndërmarrësisë si për nevojat e avancimit të tyre profesional, ashtu edhe për transferimin e shkathtësive të ndërmarrësisë dhe vlerave të qytetarisë aktive tek nxënësit e tyre. Në anën tjetër, përmes angazhimit me palët e jashtme, fakulteti do të ketë mundësinë që të procesojë reflektimet rreth cilësisë së studimeve si dhe do të jetë në gjendje të ndërtojë një imazh të ri si kontribuues në zhvillimin e sistemit të arsimit dhe shoqërisë.

Treguesit e rezultateve:

- Funksionalizohen marrëveshjet e bashkëpunimit me shkollat dhe institucionet e tjera arsimore për të zhvilluar projekte të përbashkëta.
- Zhvillohen dhe zbatohen projekte të përbashkëta me OQ-të, OJQ-të dhe organizatat me bazë në komunitet, me impakt të dukshëm në shoqëri.
- Rishikohen programet me qëllim të integritit të përmbajtjeve që synojnë zhvillimin e shkathtësive të ndërmarrësisë për studentët e rinj.
- Zhvillohen dhe zbatohen programet e zhvillimit profesional të mësimdhënësve në vazhdimësi.

5.4.1. Rezultatet, aktivitetet dhe treguesit për objektivën specifike 3

Në vijim janë prezantuar aktivitetet dhe treguesit e produktit për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme për objektivën e tretë specifike

Rezultati 1: Funkcionalizohen marrëveshjet e bashkëpunimit me shkollat dhe institucionet e tjera arsimore për të zhvilluar projekte të përbashkëta me qëllim të krijimit të lidhjes më të fortë midis fakultetit dhe institucioneve arsimore

Aktivitetet:

Treguesit e produktit:

3.1. Krijimi i platformës së bashkëpunimit me institucionet edukative dhe arsimore.

-Janë arritur dhe funksionalizuar marrëveshjet me shkollat dhe institucionet parashkollore partnere, DKA-të, Institutet me mision arsimor, etj.

3.2. Zhvillimi i praktikës pedagogjike të studenteve në institucione përtej shkollave dhe institucioneve të tjera arsimore, përfshirë organizatat qeveritare dhe joqeveritare bazuar në qëllimet e programeve studimore.

-Praktika pedagogjike realizohet në institucione të ndryshme që kanë fushëveprim edukimin dhe arsimin sidomos për profilet e programeve që kërkojnë një gjë të tillë.

Rezultati 2. Zhvillohen dhe zbatohet projekte të përbashkëta me OJQ-të dhe organizatat me bazë në komunitet, me impakt të dukshëm në shoqëri.

3.3. Rrjetëzimi i partneriteteve përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizatat për shërbim komunitar me qëllim të formësimit të vlerave të qytetarisë aktive dhe përgjegjësisë sociale

-Janë funksionalizuar marrëveshjet e bashkëpunimit me organizatat qeveritare dhe jo qeveritare.
- Është rritur angazhimi komunitar dhe vullnetar i stafit akademik dhe studentëve dhe është krijuar lidhje më e fortë me komunitetin

3.4. Organizimi i webinareve, tryezave të diskutimit dhe simpoziumeve duke përfshirë komunitetin e mësimit dhe specialistëve të tjerë të arsimit.

- Janë organizuar webinare me tema të ndryshme për grupet e interesit në baza të rregullta dhe sipas dinamikës së paraparë.
-Janë organizuar tryeza diskutimi, simpoziume e seminare duke i bërë pjesëmarrës aktiv komunitetin e mësimit dhe specialistëve të tjerë të edukimit

3.5. Lansimi i Revistës për mësimit dhe publikimi i saj në web faqen e fakultetit.

-Është lansuar revista për mësimit "Mësimit hulumtues" dhe publikohet në baza të rregullta.

Rezultati 3. Rishikohen programet me qëllim të integrimit të përmbajtjeve që synojnë zhvillimin e shkathtësisë të ndërmarrësisë dhe kompetencave të qytetarisë demokratike për studentët e rinj.

3.6. Rishikimi i programeve me qëllim të integrimit të konceptit dhe praktikës së punës vullnetare.

- Aktivitetet vullnetare janë integruar në programet e praktikës dhe kontributet vullnetare njihen dhe konvertohen në ECTS.

3.7. Rishikimi i programeve me qëllim të integrimit të konceptit të ndërmarrësisë

- Aktivitetet e ndërmarrësisë janë integruar në programet e përgatitjes së profesionistëve

<p>3.8. Themelimi i qendrave/klubeve të studenteve sipas fushave të angazhimit vullnetar (letërsi, matematikë, arte, mjedis, histori, gjeografi, STEAM, promovimi i zhvillimit të qëndrueshëm, mbështetja e nxënësve me vështirësi në mësim dhe talent, etj) që do t'ju shërbenin studentëve nëpër gjenerata)</p>	<p>arsimor dhe promovohen në vazhdimësi. - Studentët janë organizuar në klube dhe qendra për angazhim vullnetar.</p>
<p>Rezultati 4: Zhvillohen dhe zbatohen programet e zhvillimit profesional të mësimitdhënësve në vazhdimësi</p>	
<p>Aktivitetet:</p>	<p>Treguesit e produktit:</p>
<p>3.1. Ofrimi i programeve të akredituara dhe zhvillimi dhe akreditimi i programeve të reja të. Zhvillimit profesional konform nevojave të mësimitdhënësve dhe shkollave</p>	<p>-Janë zhvilluar, akredituar dhe ofruar programet e zhvillimit profesional, konform nevojave të identifikuar - Janë arritur dhe funksionalizuar marrëveshjet me shkollat dhe institucionet parashkollore partnere, DKA-të, etj. për ofrimin e programeve të zhvillimit profesional</p>

5.5. Përshkrimi i objektivës specifike 4: Qeverisja, administrimi dhe menaxhimi

Problemi kyç 4: Përfshirje e pamjaftueshme e stafit në aktivitete të zhvillimit profesional; procese jo të qëndrueshme të administrimit dhe politikave të sigurimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së punës; numër i ulët dhe mungesë e stafit profesional administrativ dhe nivel jo i kënaqshëm i kulturës organizative institucionale; aktivizëm studentor i fokusuar në çështje teknike dhe që nuk ndërlidhen me ngritjen e cilësisë në programet studimore.

Objektiva specifike 4: QEVERISJA, ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI

Zhvillimi i kulturës së qëndrueshme organizative institucionale përmes zbatimit të politikave dhe standardeve të qëndrueshme të cilësisë, llogaridhënies dhe transparencës; investimit në zhvillimin profesional të stafit akademik dhe administrativ; dhe përfshirjes së studentëve në vendimmarrje dhe në proceset e sigurimit të cilësisë.

Çështjet e cekura më lartë kërkojnë që fakulteti të ndryshojë diskursin e menaxhimit përmes zhvillimit të kulturës organizative gjithëpërfshirëse, e cila garanton llogaridhënie, transparencë dhe zbatim të politikave të qarta të standardeve të cilësisë; ofron mbështetje stafit akademik për zhvillim profesional sipas nevojave dhe interesave individuale; dhe inkurajon bashkëpunim me studentët e të gjitha niveleve përmes komunikimit të ndërsjellë dhe përfaqësimit të denjë të interesave dhe të drejtave të studentëve për përgatitje cilësore profesionale.

Treguesit e rezultateve:

- Hartohen dhe zbatohen procedura efikase të zbatimit të politikave dhe standardeve të cilësisë, llogaridhënies dhe transparencës në të gjitha nivelet
- Zbatohen programe cilësore të zhvillimit profesional të stafit akademik dhe administrativ sipas qasjes së individualizuar
- Aktivizmi studentor orientohet në avokim për respektim të të drejtave të studentëve për mësim cilësor
- Laboratorët dhe hapësirat mësimore modernizohen për të inkurajuar integrimin ndërlëndor dhe konkretizimin e të nxënit.

5.5.1. Rezultatet, aktivitetet dhe treguesit për objektivën specifike 4

Në vijim janë prezantuar aktivitetet dhe treguesit e produktit për arritjen e secilit nga rezultatet e pritshme për objektivën e katërt specifike

Rezultati 1. Hartohen dhe zbatohen procedura efikase të zbatimit të politikave dhe standardeve të cilësisë, llogaridhënies dhe transparencës në të gjitha nivelet	
Aktivitetet:	Treguesit e produktit:
4.1. Formalizim dhe komunikim i gjerë i politikës për sigurimin e cilësisë duke përfshirë edhe shfrytëzimin e të dhënave që dalin nga ky sistem;	<ul style="list-style-type: none"> - Politika për sigurimin e cilësisë është shpërndarë tek të gjithë akterët relevant. - Instrumentet e dala nga politika për sigurimin e cilësisë janë zbatuar në mënyrë periodike. - Të dhënat janë analizuar dhe shfrytëzuar si bazë për vendimmarrje për çështje të ndryshme akademike, menaxheriale dhe administrative.
4.2. Zhvillimi i rregulloreve, udhëzuesve për definim të procedurave standarde të veprimit për procese të caktuara menaxheriale dhe administrative dhe publikimi i pakos menaxheriale dhe administrative për të definuar çështjet specifike të funksionimit;	<ul style="list-style-type: none"> - Janë hartuar procedura për diplomim në Bachelor dhe master; transfer të kredive, kërkesa për lëshim të dëshmimeve për transkript dhe kopje të programeve; barasvlerësim të programeve pas ndryshimit të programit; implementim të punës praktike në shkollë; etj. - Pakoja menaxheriale është publikuar dhe shfrytëzohet nga administrata, personeli akademik dhe studentët.
4.3. Funksionalizimi i trupave proaktive dhe monitoruese për hetim dhe trajtim të shkeljeve të etikës;	<ul style="list-style-type: none"> - Komisioni i etikës dhe ai disiplinor janë funksionalizuar dhe funksionojnë sipas procedurave të shkruara dhe miratuara.
4.4. Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të menaxhimit të informatave	<ul style="list-style-type: none"> - Janë zhvilluar dhe mirëmbajtur databazat për menaxhimin e informatave (regjistrimi dhe diplomimi; kohëzgjatja e studimeve; kalueshmëria në provime; mobilitetet e studentëve dhe stafit, publikimet shkencore, projekteve, etj). - Stafit akademik dhe administrativ i është siguruar qasja në dokumentet e rëndësishme përmes dosjeve të hapura elektronike (shared documents).
4.5. Shqyrtimi i performancës së stafit akademik sipas procedurave dhe instrumenteve të parapara në politikën për sigurimin e cilësisë.	<ul style="list-style-type: none"> - Performanca e stafit akademik është shqyrtuar duke u bazuar në politikën e sigurimit të cilësisë dhe janë aplikuar instrumentet e parapara.
4.6. Hartimi i planeve të përmirësimit pas secilit proces të akreditimit dhe në bazë të të	<ul style="list-style-type: none"> - Planet për përmirësimin e cilësisë së programeve janë hartuar bazuar në

dhënave të mbledhura nga implementimi i sistemit të sigurimit të cilësisë.	rekomandimet e dala nga procesi i akreditimit dhe nga të dhënat e mbledhura përmes instrumenteve të cilësisë.
4.7. Hartimi i planeve vjetore të punës së fakultetit për informim të Këshillit, Rektoratit dhe publikut të gjerë dhe palëve me interes.	- Këshilli i Fakultetit, rektorati dhe palët e tjera të interesit janë informuar në mënyrë periodike përmes raporteve transparente.
4.8. Implementimi i dokumentit që përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik duke përfshirë mësimdhënien, shkencën dhe shërbimin ndaj fakultetit;	- Është zhvilluar dhe zbatuar dokumenti që përcakton qartë detyrat dhe përgjegjësitë e personelit akademik duke përfshirë edhe vendimmarrjen e bazuar në caktimin e detyrave, role dhe ofrimin e mundësive.
4.9. Hartimi i politikës së angazhimit të personelit akademik në mësimdhënien duke marrë parasysh vendimin e angazhimit (kontratën), profilin e personelit dhe parimin e korrektesisë në raport me kolegët e tjerë.	- Është hartuar politika e cila shfrytëzohet për angazhimin e personelit akademik. - Ndarja dhe caktimi i orëve për mësimdhënie është bërë përmes një procesi të mirëdefinuara.
4.10. Hartimi dhe fuqizimi i politikës për zhvillimin e kuadrove në FEdu duke përfshirë identifikimin e fushave prioritare në edukim, prioritetet e FEdu dhe sistemit të arsimit, nevojën për inovacion, dhe adresimin e zbratësirave të kuadrove për realizim cilësor të misionit të FEdu.	- Është hartuar politika për zhvillimin e kuadrove të FEdu, e cila bazohet në: identifikimin e fushave prioritare në fushën e edukimit, prioritetet e FEdu dhe sistemit të arsimit, nevojën për inovacion, dhe adresimin e zbratësirave të kuadrove për realizim cilësor të misionit të FEdu. - Konkursët për avancim dhe rekrutim të personelit të ri akademik kanë reflektuar nevojat prioritare dhe adresojnë potencialin për zhvillim të fakultetit dhe sistemit të arsimit.
4.11. Organizimi i takimeve profesionale periodike në nivel departamenti me qëllim të diskutimit të aspekteve të ndryshme programore dhe shkencore.	- Departamentet kanë organizuar takime profesionale periodike ku janë trajtuar aspekte të ndryshme bashkëpunimi. - Formalizohen iniciativat e departamenteve në formë zyrtare për rritje të cilësisë programore.
4.12. Zhvillimi i mekanizimit për identifikimin dhe përzgjedhjen meritore për arritjet akademike/shkencore të stafit akademik të dalluar në fushën e mësimdhënies dhe hulumtimit.	- Është krijuar mekanizmi për identifikimin dhe përzgjedhjen meritore të stafit të dalluar në mësimdhënie dhe hulumtime shkencore. - Fakulteti ka ndarë mirënjohje në baza vjetore për personelin me arritje të dalluara akademike dhe shkencore.
Rezultati 2. Zbatohen programe cilësore të zhvillimit profesional të stafit akademik dhe administrativ sipas qasjes së individualizuar	
4.13. Organizimi i trajnimeve për stafin akademik dhe administrativ konform planeve individuale që dalin nga shqyrtimi	- Janë organizuar forma të ndryshme të zhvillimit profesional të stafit akademik dhe administrativ sipas nevojave dhe interesave individuale

performancës.	profesionale të dala nga vlerësimi i performancës.
Rezultati 3. Aktivizmi studentor orientohet në avokim për respektim të të drejtave të studentëve për mësim cilësor.	
4.14. Fuqizimi i Këshillit studentor për aktivizëm studentor (tryeza të diskutimit, trajnime, aktivitete, etj);	- Janë organizuar takime, trajnime, tryeza diskutimi dhe aktivitete të tjera të cilat fuqizojnë aktivizmin studentor të orientuar drejt cilësisë.
4.16. Organizimi i ditëve të orientimit për studentët e rinj.	- Studentët aktual me përkrahjen e departamentit dhe stafit administrativ kanë pritur dhe informuar studentët e rinj për fakultetin (çështjet administrative, programi, SEMS, biblioteka, sallat mësimore, jeta studentore etj.) - Pakoja informative për studentët e rinj është publikuar në ueb faqe dhe rrjete të tjera të informimit.
4.17 Hapja e shërbimit për përkrahje të studentëve në nevojë (peer to peer support)	- Është lansuar dhe funksionalizuar shërbimi mbështetës për studentët me vështirësi sociale, emocionale, mësimore, etj. dhe administrohet nga studentët
Rezultati 4. Laboratorët dhe hapësirat mësimore modernizohen për të inkurajuar integrimin ndërlëndor dhe konkretizimin e të nxënit	
4.18 Pajisja e sallave të mësimi me pajisje demonstruese dhe modernizimi i laboratorëve për mësim të integruar	- Është hartuar plani për shfrytëzimin optimal dhe përmirësimin e infrastrukturës - Janë pajisur sallat me smart boards, qasje në internet dhe pajisje konkretizuese - Janë siguruar hapësirat e punës individuale dhe grupe të studentëve - Janë modernizuar laboratorët (p.sh Lab STEAM) për mësim të integruar - Janë funksionalizuar hapësirat mësimore me pajisje demonstruese për edukimin fillor dhe EFH

6. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Plani zhvillimor i Fakultetit të Edukimit (PZHFE) do të monitorohet në mënyrë periodike për të përcjellë zbatimin e tij, por edhe do t'i nënshtrohet vlerësimit objektiv për të parë nëse janë arritur objektivat e planifikuara, nëse ka pasur ndikim dhe nëse ndryshimet janë të qëndrueshme.

Plani zhvillimor do të zbatohet bazuar në planet vjetore të veprimit, ku do të përcaktohen caqet specifike dhe të matshme, të cilat mundësojnë edhe monitorimin e përvjetshëm të arritjes së rezultateve dhe aktiviteteve të planifikuara.

Monitorimi në baza vjetore do të përcaktojë nëse ka indikacione se produktet po ndikojnë në arritjen e objektivave, për të përcaktuar nevojën e ndryshimeve eventuale të ndonjë aspekti të planifikuar që mund të dalë nga analiza e raporteve, statistikave dhe monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të aktiviteteve dhe matjes së treguesve.

6.1. Përcaktimi kornizës për monitorim

PZHFE do të vlerësohet në dy periudha: në gjysmë të zbatimit (qershor 2024) dhe në fund të periudhës pesë vjeçare. Vlerësimi do të fokusohet në pesë aspekte themelore, si:

- a) Relevanca- A kanë qenë të duhura aktivitetet e ndërmarra?
- b) Efektiviteti- Deri në çfarë mase janë arritur rezultatet e synuara?
- c) Efikasiteti- Sa dhe si janë shfrytëzuar resurset njerëzore dhe financiare?
- d) Ndikimi- Cilat janë ndryshimet e arritura si rezultat i ndërhyrjeve të realizuara?
- e) Qëndrueshmëria- Sa do të jenë të qëndrueshme rezultatet dhe ndryshimet e arritura?

6.2. Metodologjia dhe instrumentet

Metodologjia e vlerësimit të zbatimit të planit zhvillimor do të bazohet në kornizën për monitorim dhe vlerësim, që do të përpilohet nga grupi monitorues.

6.3. Përcaktimi i grupit monitorues

Zbatimi i planit zhvillimor do të monitorohet dhe vlerësohet nga grupi monitorues i cili formalizohet me vendim nga Dekani i Fakultetit.